

**DI**  
DRITA ISLAME



**TË JETOSH PËR**  
*Përyjetësi*



# Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

“Drita islame”  
Botim i Komunitetit Mysliman  
të Shqipërisë

DREJTOR  
Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR  
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA  
Erzen Carja

KONTAKT:  
Tel/fax 04 223 04 092  
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXIII i botimit  
Nr. 08 (495)  
Gusht, 2024

ISSN 2226-7115



Artikujt  
që vijnë në redaksi  
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht  
edhe pikëpamjet e revistës.

Materialet e sjella në redaksi,  
pavarësisht nëse botohen apo jo,  
nuk i kthehen autorit.

## PËRMBAJTJA

4 Të jetosh për përjetësi / Mehmet Disha

6 Butësia dhe delikatesa në rugën tonë / Dorian Demetja

8 Lajme / Aktivitete



12 Përse vazet dhe hutbet shpesh  
nuk kanë ndikim mbi audiencën / Bediuzzaman Said Nursi

14 Mbi krizën morale të modernitetit / Abdullah Bulku

18 Dashuria është... / Nilhal Balxhë

20 Diferenca mes fjalëve grua, bashkëshorte  
dhe shoqe në Kur'anin Fisnik / Bledar Myftari

22 Gënjeshtra është ves, jo virtyt! / Naim Driçaj

24 Raportet e kulturës së myslimanit  
bashkëkohor me kulturat e tjera / Prof. Dr. Hfiz Hajredin Hoxha

26 Disa çështje rreth pushimeve / Redaksia



28 Morali i lartë i resulullahut dhe sjelljet e tij,  
që u bënë shkak për udhëzimin e njerëzve / M. Jusuf Kandeheleui

30 Të njoftim veten / Retrospektivë

32 Jeta e prijësit Ebu Hanife / Personalitet

36 Shërimi i brengave dhe problemeve nën hijen  
e Kur'anit dhe Sunetit / Dr. Abdullah el-Hatir



# Te jetosh

## PËR PËRJETËSI



Njeriu është krijuar për të ndjekur udhë që nuk ngecin në të përkohshmen. Kjo është një natyrshmëri e brendshme, që gjendet apriori tek çdo njeri. Ne vetë i duam gjërat që të zgjasin, që të jenë gjithmonë të vazhdueshme, pra gjëra të rrjedhshme, qoftë ajo mirësi, begati, ushqim a ujë, qofshin të ardhura financiare, si dhe po ashtu, duam që plakja të mos na zërë dhe që njerëzit e dashur të na gjenden gjithnjë pranë. Duke qenë se jeta e kësaj bote nuk përmbush këto nevoja që ne i kemi të brendshme, atëherë, i bie që ne jemi krijuar për përjetësi, dhe brenda nesh është vendosur kriteri, a motorri që do të jetë gjithnjë kërkues i përjetësisë, pra Xhenetit.

Për këtë arsye, Xheneti, parajsa nuk është aspak e huaj për ne, apo aspak utopike e as abstrakte, është, në të vërtetë, diçka që ne e duam me gjithë fuqinë e shpirtit. Po të dëgjojmë rënkimet e zemrës, do mbajmë vesh se prej saj, ashtu siç dilnin rënkimet e profetit Ibrahim a.s., teksa hakërrehej se "Nuk i dua ata që perëndojnë!..."<sup>1</sup>, po ashtu edhe zemrat tona lëngojnë për përjetësi, dhe Zoti ka premtuar që do e japë.

Ekzistenca e gjithçkaje, vetitë e tyre dhe aftësitë në domethënien absolute dëshmojnë për ekzistencën dhe njësinë e Allahut (xh.sh). Po kwshtu, edhe njeriu wshtw pasqyrw ku reflektohen dhe pasqyrohen Cilwsitw e Zotit, dhe njeriu me nevojat dher dobwsitw qw ka, twrheq dritwn e Atributeve tw pafundme e tw pwrSORURA dhe tw pakufizueshme tw Allahut.

Bediuzamani i nderuar e ilustron këtë çështje në disa vende, me shembuj të ndryshëm. Për shembull, piklat në sipërfaqe të ujit të një lumi që reflektojnë diellin. Me largimin e tyre, diellin fillojnë ta reflektojnë të tjera pikla uji. Ja, pikërisht kjo gjendje tregon

1. Kur'an, 6:76.

se ky reflektim nuk është tipar i atyre piklave, sepse ndoshta gjendet një diell i përjetshëm që këto pikla e marrin aftësinë prej tij dhe pastaj mund të zhbëhen. Ato që i pasojnë tregojnë po ashtu gjendjen dhe vetitë e të parave. Kështu që dielli, i cili reflektohet në fytyrën e tyre, ose Dielli i reflektuar dëshmojnë për pafillimësinë dhe përjetësinë.

Po të njëjtat krijesa, me të qenët kalimtare dhe me fundet e tyre dëshmojnë për përjetësinë dhe vazhdimësinë e pandërprerë të të Allahut që është i Përjetshmi i Përherëshëm dhe këtë mund ta quajmë si shfaqje të dytë.

Të qenët e tyre kalimtare tregon se ato do të zhbëhen dhe do të largohen gjithnjë, mirëpo zhdukja e tyre nuk e perëndon asnjëherë diellin. Sepse ai është një diell që nuk perëndon me këto largime.

Ekzistenca dëshmon vetë Allahun (xhel'le xhelaluhhu), cilësitë dhe emrat e Tij; ndërsa të qenët kalimtare dhe mbarimi dikur i ekzistencës, pra zhdukja e saj pasi ka ekzistuar njëherë dhe shfaqja e të tjera krijesave të ngjashme po nga asgjëja, tregojnë për dikë që nuk është i destinuar që të jetë kalimtar apo të gjejë fund ndonjëherë. Ata që vijnë, ikin një ditë ashtu siç erdhën dhe si ekzistenca e tyre, ashtu edhe zhdukja vjen përmes një urdhri të epërm. Dhe me ikjen e tyre marrin me vete gjithçka që është e tyreja.

Meqë këto janë rreze të vetë Allahut (xh. sh.), të cilësive dhe të emrave të Tij, edhe zhdukja e perëndimi i tyre një ditë nuk duhet ta trishtojë njeriun. Sepse ato kanë një burim të tyrin, të përjetshëm dhe ata që kanë për të ikur do të ikin një ditë. Në të tilla raste, njeriu duhet të thote: "Unë nuk i dua ata që zbehen e perëndojnë."

**Mehmet Disha**

# Butësia dhe delikatesa në rrugën tonë

Një ditë, një grup hebrejsh të Medines erdhën pranë Profetit (a.s.) dhe me një lojë të thjeshtë fjalësh, duke e ndryshuar fjalën e njohur përshëndetëse “es-selamu alejkum” (Paqja qoftë mbi ju!), thanë “es-samu alejkum” (Vdekja qoftë mbi ju!), duke treguar një vrazhdësi të madhe ndaj të dërguarit të Allahut. Nëna e besimtarëve, Aishja (r.anha), ishte aty pranë dhe duke mos e mbajtur dot veten pa reaguari ndaj kësaj vrazhdësie të tyre, ua ktheu duke u thënë: “Mallkimi dhe hidhërimi i Allahut qoftë mbi ju!” Profeti i dhembshurisë dhe i mëshirës (a.s.) duke iu drejtuar bashkëshortes së tij, i tha: “Qetësohu o Aishe! Duhet të jesh e sjellshme dhe e butë, duhet të ruhesh nga sjellja e vrazhdë dhe nga fjala e shëmtuar.” Aisheja iu drejtua sërish Profetit (a.s.) me pyetjen: “A nuk e dëgjove ç’thanë ata?” I dërguari i Allahut ia ktheu: “Edhe unë ua ktheva atyre: ‘ue alejkum!’ (edhe mbi ju!)”<sup>1</sup>

Të qëndruarit larg vrazhdësisë në fjalë e në sjellje, të mos lëndosh, ta përmbash zemërimin dhe të jesh pajtues, janë tregues se njeriu është edhe i sjellshëm, edhe besimtar i matur e i pjekur. Profeti ynë i dashur e përshkruan këtë besimtar duke thënë: “Besimtari është si bleta. Ha atë që është e pastër dhe prodhon (mjaltin) atë që është e pastër; kur ulet mbi një lule nuk e thyen dhe as e prish atë.”<sup>2</sup> Me këtë metaforë ai e tregon besimtarin si njeri që nuk thyen e nuk shkatërrojnë, që bënë punë të pastra e legjitime, të dobishme dhe fisnike. Nga ana tjetër, atë që e braktisin njerëzit për shkak të vrazhdësisë dhe vulgaritetit të tij, e ka cilësuar si “njeriun më të keq.”<sup>3</sup>

Fjalët e mëposhtme të Enes b. Malikut (r.a.), i cili është rritur nën kujdesin dhe në shtëpinë e të dërguarit të Allahut, tregon se sa i kuptueshëm dhe i sjellshëm ka qenë Profeti (a.s.) ndaj shërbëtorëve, madje edhe ndaj fëmijëve: “Profetit i shërbeva për 10 vjet rresht. Pasha Allahun kurrë nuk më tha: Uf! Kur bëja diçka nuk më qortonte duke më thënë: Pse e bërë kështu! Sikur ta kishe bërë ashtu!”<sup>4</sup> Kjo sepse, qetësia, butësia dhe

mirësjellja përbënin karakterin themelor të Profetit të Mëshirës. I dërguari i Allahut duke thënë se, “Butësia (delikatesa) e zbukuron një punë, kurse mungesa e butësisë (delikatesës) e bën të metë atë”<sup>5</sup>, e cilësonte si të padobishëm njeriun që sillej vrazhdë e ashpër.

Allahu e dërgoi Profetin Musa (a.s.) te Faraoni dhe i thotë: “Flitini atij fjalë të buta, se ndoshta mendohet a frikësohet”<sup>6</sup>. Sepse qëllimi nuk është hakmarrja, por thirrja drejt së vërtetës e shpëtimit. Profeti ynë (a.s.) e ka përkufizuar si më poshtë vetëpërmbajtjen në zemërim duke e penguar dëshirën për të sharë dhe për të folur keq: “Mundës nuk është ai që i mund kundërshtarët. Mundës i vërtetë është ai që arrin ta përmbajë veten në zemërim.”<sup>7</sup> Rezultatet më të qarta të zemërimit reflektohen në gjuhën e njeriut. I zemëruari në përgjithësi shan, fyjen ose sillet vrazhdë me personin me të cilin zemërohet.

Muslimani i cili përballet me sharje, nuk duhet ta ulë nivelin e tij duke nxjerrë nga goja sharje, qoftë edhe në kundërpërgjigje. Edhe pse e vështirë, duhet të durojë dhe nuk duhet të shëmtohet duke iu përshtatur sharësit. Kur një person i quajtur Ebu Xhurej, i kërkon këshillë për vete të dërguarit të Allahut, Profeti (a.s.) i thotë: “Mos shaj askënd!” dhe vazhdon me këto fjalë: “... Nëse dikush të shan ty dhe të ofendon për diçka që e di se ti e ke, ti mos e ofendo atë për gjërat që di për të! Sepse faji për këtë i takon atij.” Ebu Xhurej thotë: “Pas kësaj nuk kam sharë askënd, qoftë njeri i lirë apo skllav, deve apo dele.”<sup>8</sup>

Dy njerëz folën shumë rëndë kundër njëri-tjetrit në prani të të Dërguarit të Allahut. Ndërsa njëri prej tyre shante, tjetri heshtte e nuk i përgjigjej. Kur edhe ai filloi t’i përgjigjej me të shara, i Dërguari i Allahut u çua dhe iku prej aty. Kur e pyetën se pse u largua, tha: “Kur u çuan melekët edhe unë u çova bashkë me ta. Përderisa i heshturi vazhdonte të heshtte, melekët i përgjigjeshin sharësit për të. Por kur filloi edhe ai të përgjigjej me të

1. Muslim, Selam, 11.

2. Ibn Hanbel, II, 199.

3. Buhari, Edeb, 38.

4. Muslim, Fedail, 51.

5. Muslim, Birr, 78.

6. Taha, 20:44.

7. Buhari, Edeb, 76.

8. Ebu Daud, Libas, 25.

shara, edhe melekët u larguan prej aty.”<sup>9</sup>

I Dërguari i Allahut, me qëllim që të mos hidhërohen bijtë dhe të afërmit myslimanë, e ka ndaluar që të shahen edhe jobesimtarët dhe idhujtarët. Është ndaluar të shahen edhe besimet dhe vlerat e shenjta të njerëzve. Sipas Islamit, edhe nëse besimet e njerëzve janë tërësisht të gabuara, nuk duhen sharë, madje as idhujt të cilëve ata u falen. Sepse kjo sjellje i hap rrugën urrejtjes dhe armiqësisë. Veç kësaj, nëse shajmë besimin e dikujt, kjo mund ta shtyjë atë që të shajë vlerat tona. Prandaj Allahu i Madhëruar ka urdhëruar: “Mos i shani idhujt që ata i adhurojnë në vend të Allahut, në mënyrë që ata të mos e shajnë Allahun armiqësisht nga padija.”<sup>10</sup> Sepse përmes metodash dhe rrugësh të shëmtuara si sharja, nuk mund të arrihet asgjë e dobishme, e mirë dhe e bukur.

I dërguari i Allahut, i cili i ka urdhëruar myslimanët që në të gjitha punët e tyre të sillen me elegancë, butësi e edukatë, vetë ai nuk e ka lënë kurrë mënjanë mirësjelljen ndaj të gjithë të afërmeve, duke filluar nga familja e tij, ndaj shokëve dhe ndaj të gjithë njerëzve. Sekreti se si Profeti i Islamit arriti të realizonte atë ndryshim rrënjësor tek beduinët arabë përkundër natyrës së tyre të vrazhdë e të ashpër, duhet kërkuar në zemrën e tij të butë, në të folurin e tij elegante e fisnike, si dhe në aktet e tij falëse.

Allahu në Kur’an i drejtohet Profetit Muhamed (a.s.) kështu: “Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje.”<sup>11</sup> Kurse Profeti Muhamed (a.s.) thotë: “Besimtari nuk është njeri që shpif për nderin e njerëzve, që mallkon, që bën punë të shëmtuara dhe që flet pa edukatë.”<sup>12</sup>

Ebu Hamid el- Gazali, i njohur si imam Gazali, konsiderohet si njëri nga dijetarët me ndikimin më të madh në historinë e njerëzimit. Atij i është dhënë epiteti “Autoritet i Islamit”. Ai thotë: “Përpiqu të debatosh sa më pak për çfarëdo qoftë. Në debate ka më shumë dëm sesa dobi. Ato janë burim i të gjitha cilësive të këqija si dyfytërsia, lakmia, mendjemadhësia, urrejtja, armiqësia, lavdërimi e të ngjashme. Por, nëse në praninë tënde diskutohet për diçka, dhe ti e sheh se pa ty e vërteta nuk do të dalë në pah, në atë rast të lejohet që të përfshihesh në diskutim me qëllimin e vetëm që të ndihmohesh në triumfin e së vërtetës. E për këtë ka dy tregues: 1) Ti dëshiron të thuhet e vërteta, qoftë nga ti apo nga kundërshtari yt. 2) Të dëshirosh më shumë të diskutosh i tërhequr, se sa para syve të njerëzve (në publik). Por, nëse po debaton për një çështje të caktuar, ndërkohë që ti je i bindur se ke të drejtë dhe që tjetri po debaton vetëm për t’u fjalosur, atëherë jepi fund atij diskutimi menjëherë, përndryshe lindi zilia dhe ofendimet, e kurrfarë dobie nuk del.

9. Buhari, el-Edebu’l Mufred, 151.

10. En’am, 6:108.

11. Ali-Imran, 3:159.

12. Tirmidhi, Birr, 48; Ibn Hanbel, I, 405.

Shpjegimi i dobisë:

Të pyesësh është sikur t’i tregosh mjekut për të sëmurin, dhe përgjigja është angazhimi i mjekut që i sëmuri të shërohet. Të padijshmit janë të sëmurë, kurse dijetarët mjekë. Dijetari i dobët nuk di të shërojë mirë, ndërsa dijetari i vërtetë shëron atë që kërkon shërim dhe për të cilin mendon se mund të shërohet. Nëse sëmundja është kronike dhe e pashërueshme, e gjithë aftësia që i nevojitet mjekut do të jetë të shohë padobinë e shërimit, që të mos harxhojë kohën kot. Padituria është sëmundje shumë e rrezikshme dhe është katër llojesh. Vetëm një lloj është i shërueshëm, kurse tri të tjerat nuk kanë kuptim të shërohen:

Lloji i parë. Ky është ai që pyet nga zilia, ndërkohë ia kthen shpinën diturisë nga urrejtja. Zilia është sëmundje e pashërueshme. Në këtë drejtim, nuk duhet as t’i kthesh përgjigje, sepse edhe nëse i jep përgjigjen më të mirë e më të qartë, me këtë vetëm sa e shton urrejtjen, armiqësinë dhe zilinë e tij. Për të tillët është thënë: “Çdo armiqësi është e kalueshme, përveç asaj që vjen nga zilia. Ajo nuk kalon”. Më e mira është që ata të lihen e të vuajnë nga kjo sëmundje, ashtu siç thotë Allahu i Lartësuar: “Braktise dhe mos u brengos për atë që Neve na ka harruar e që kërkon vetëm kënaqësitë e kësaj bote.” Gjithçka që bën e flet ziliqari, vetëm sa e ndez zjarrin, duke shkatërruar kështu frytin e punës së tij. Profeti Muhamed (s.a.s.), ka thënë: “Zilia i shkatërron veprat e mira, si zjarri që i djeg drutë.”

Lloji i dytë. Është injoranca, e cila gjithashtu është sëmundje e pashërueshme. Profeti Isa (a.s.) ka thënë: “Kam mundur të ngjall të vdekurin, me lejen e Allahut, por e kisha të pamundur të shëroj injorantin.” Injorant konsiderohet ai që kalon pak kohë duke kërkuar dituri, e mendon se s’ka më të djshëm. Futet lehtë në debate dhe merr guximin për të kundërshtuar edhe dijetarët më të mëdhenj, që kanë kaluar jetën duke kërkuar dituri. Ky mendon se çfarë nuk di ai, nuk mund ta dijë askush. Është injorancë t’i përgjigjesh këtyre njerëzve.

Lloji i tretë. Ky është personi që dëshiron të mësojë dhe vetëm për këtë qëllim pyet, mirëpo është aq i padurueshëm, sa edhe ndaj përgjigjes më të mirë, nuk arrin ta kuptojë të vërtetën, por kupton vetëm atë që ka interes. Edhe këtij më mirë është të mos i përgjigjesh. Profeti Muhammed (a.s.) ka thënë: “Ne profetëve, na është urdhëruar që njerëzve t’u flasim aq sa ata mund të kuptojnë.”

Lloji i katërt. Padituria që mund shërohet si sëmundje, është padituria e të sëmurit, i cili pa kurrfarë inati, zilie apo dëshirë të ulët, dëshiron të fitojë dituri, prandaj edhe pyet. Jo nga inati, por për shkak të dashurisë që ka për diturinë. Një i sëmurë i tillë duhet shëruar dhe duhet përgjigjur pyetjeve të tij.”<sup>13</sup>

**Dorian Demetja**

13. Ebu Hamid el- Gazali, Ejuhe’l Ueled (O djalosh).



# 1

## DIPLOMOHET BREZI I TRETË I STUDENTËVE TË INSTITUTIT TË STUDIMEVE ISLAME "HAFIZ SABRI KOÇI"

Instituti i Studimeve Islame "Hafiz Sabri Koçi", organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, zhvilloi në ambientet e Kolegjit Universitar "Bedër", ceremoninë e diplomimit të brezit të tretë të studentëve të programit një vjeçar për formim të përgjithshëm fetar.

Në vitin e tij të tretë të aktivitetit, Instituti i Studimeve Islame "Hafiz Sabri Koçi", diplomoi 38 studentë, meshkuj dhe femra.

Në këtë ceremoni, morën pjesë: Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Nënkrjetari Taulant Bica, i cili është njëkohësisht përgjegjësi i mbarëvajtjes së këtij instituti, Përgjegjës i Departamentit të Shkencave Islame në Kolegjin Universitar "Bedër", Prof. Xhemal al Saferti, si dhe myftinj, imamë, pedagogë dhe studentët që u bënë pjesë e këtij trajnimi përgjatë gjithë vitit që lamë pas.

Në fjalën e tij përshëndetëse, kryetari Spahiu, pasi uroi studentët për përfundimin me sukses të këtij programi, bëri një rezumë të shkurtër të rrugëtimit 3-vjeçar të institutit dhe efektit pozitiv që ka pasur ky i fundit në plotësimin e nevojave të KMSH-së me kuadro në terren.

Studentët i përshëndeti gjithashtu edhe Nënkrjetari Bica, i cili shprehu vlerësim të lartë për ta dhe ju uroi atyre suksese në praktikimin e këtyre dijeve të marra përgjatë gjithë trajnimit.

Në cilësinë e Përgjegjës të Departamentit të Shkencave Islame në Kolegjin Universitar "Bedër", Prof. Xhemal al Saferti, në fjalën e tij u ndal në rëndësinë e shpërndarjes në mënyrë sa më të pastër e të drejtë të mesazhit universal të Islamit tek besimtarët dhe shoqëria mbarë.

Pas fjalëve të rastit, studentët e diplomuar nga ky vit u pajisën me certifikatat përkatëse, certifikata të cilat ua dorëzoi personalisht Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu dhe të lartëpërmendurit e tjerë.







## 2

**ZHVILLOHEN MBLEDHJET PËR PLANIN STRATEGJIK 2024-2029**

Përgjatë dy javëve të para të muajit korrik, kryesia e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, zhvilloi mbledhjet me të gjitha myftinitë për zhvillimin e planit strategjik 2024 - 2029.

Tematika e këtyre mbledhjeve të zhvilluara me myftinjtë ishte vizioni i zhvillimit për pesë vitet e ardhshme në aspektin e jetës fetare, pronave, financave, burimeve njerëzore, proceseve gjyqësore, marrëdhënieve ndërinstitucionale dhe aktiviteteve social-kulturale për çdo myftini të vendit.

Diskutimi mbi planin e zhvillimit afat shkurtër, afat mesëm dhe afat gjatë të institucionit në të gjitha nivelet, vjen si një nevojë e theksuar e kohës ku ndodhemi, kërkesave të besimtarëve që përfaqësojmë por edhe si një detyrim institucional, me qëllimin e vetëm të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës nga organet dhe nëpunësit e KMSH-së.

Si rrjedhojë, këto takime u zhvilluan në formën e një bashkëbisedimi, ku myftinjtë të ndarë në grupe parashtronin raportet e myftinive përkatëse para kryesisë së institucionit dhe Kryetarit H. Bujar Spahiu. Gjatë këtyre mbledhjeve pati sugjerime të ndryshme nga anëtarët e kryesisë mbi çështje specifike të sjella në fokus nga raportet e myftinive.

Ky proces gjithëpërfshirës ka si synim mbledhjen, përpunimin dhe adresimin e sugjerimeve apo kërkesave mbi sektorë të caktuar, si në qendër ashtu dhe në bazë, dhe ndërtimin mbi to të një plani pune apo axhende për një periudhë 5-vjeçare.

Të gjitha raportet dhe diskutimet e këtyre mbledhjeve do të zbardhen dhe do të ndiqen në terren përgjatë gjithë 5-vjeçarit në vazhdim.





### 3

#### TAKIM ME GRATË MURSHIDE TË HAXHIT

Murshidet e grave haxheshja të këtij viti, në bashkëpunim me Zyrën e Gruas pranë Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, zhvilluan një takim në ambientet e institucionit me disa nga gratë të cilat këtë vit patën mundësinë të vizitojnë vendet e shentja.

Gjatë këtij takimi, ato ndanë së bashku kujtimet dhe momentet më të bukura që përjetuan gjatë haxhit, vizitave në Medine si dhe mbresat e kthimit pranë familjarëve të tyre.

Një tjetër pikë e këtij takimi ishte edhe prezantimi me aktivitetin e zyrës së gruas pranë KMSH-së, nga përgjegjësjja e kësaj zyre, znj. Fatma Karaj, e cila ndau me to një pjesë të aktiviteteve më të rëndësishme vjetore dhe theksoi mundësitë e angazhimit të mundshëm të grave pjesëmarrëse në vazhdim.





## 4

### FETVAJA DHE KONSTRUKTI MORAL NË NJË BOTË TË PËRSHPEJTUAR

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, ndodhet për një vizitë zyrtare në Kairo, ku me ftesë të posaçme nga Myftiu i Egjiptit, Shkëlqesia e Tij, Sheuki Ibrahim Al-lam, po merr pjesë në konferencën e tetë ndërkombëtare, me temë: "Fetvaja dhe Konstrukt i Moralit në një Botë të Përsheptuar", e organizuar kjo nga Myftinia e Egjiptit, nën kujdesin e Shkëlqesisë së Tij, Abdul-Fetah el-Sisi, President i Republikës.

Kjo konferencë mbledhi së bashku drejtues institucionesh fetare, studiues dhe akademikë nga më shumë se njëqind vende të botës.

Fokusi i temave të trajtuara gjatë këtyre dy ditëve në të cilat po zhvillon punimet e saj konferenca, janë problematikat më aktuale dhe të rëndësishme që lidhen me fetvanë dhe ndikimin e saj në ndërtimin e moralit në shoqëri.

Gjatë qëndrimit në Kairo, kryetari Spahiu, shoqërohet nga Sekretari i Përgjithshëm, z. Fezi Shaholli dhe Drejtori i Financave z. Edison Hoti.



# Përse vazet dhe hutbet shpesh nuk kanë ndikim mbi audiecën

Sipas këndvështrimit të Said Nursiut, Shumw teologw ose dijetarë mendojnë se shpjegojnë gjithçka para një audience e cila wshtw nw nivele të ndryshme perceptimi dhe përthithjeje. Ata mendojnë së arrijne tek publiku pa kurrëfarë pengese të të nxënit. Duke qenë se jetojmë ne periudhë ku teknologjia e informacionit është tejet e perparuar dhe komunikimi me publikun është bërë shumë i lehte, dijetari i shquar Said Nursi na ka sjellë këtë qasje.

Fjalimet e paqarta, të paekuilibruara dhe të pasakta ose të pamjaftueshme në emër të fesë, dëmtojnë fenë dhe gjithashtu krijojnë keqkuptime te njerëzit që nuk kanë njohuri për fenë dhe që për shkak të mjedisit ku janë rritur, janë ose të distancuar nga feja, ose të huaj, ose kundërshtarë të saj. Këto keqkuptime mund të bëjnë që këta njerëz të largohen plotësisht nga feja.

Kjo është një përgjegjësi me një barrë shumë të rëndë.

Kjo është një çështje për të cilën Said Nursi ka tërhequr vëmendjen, duke diagnostikuar gjithashtu me saktësi sëmundjet e shoqërisë islame në fillim të shekullit të kaluar.

Në artikujt e tij të shkruar për gazetatat e Stambollit, në fjalimin e tij "Hürriyete Hitap" dhe në bisedat e tij me mjekët në Toptaşı, Said Nursi ka thënë: "Dëgjova vaizët, por këshillat e tyre nuk më ndikuan." Ky është një shembull i analizave dhe shpjegimeve që ai bëri për të diagnostikuar shkaqet dhe për të ofruar zgjidhje për këtë problem.

Atje ai thotë: "Përveç ngurtësisë së zemrës sime, gjeta edhe tre arsye të tjera."

(Këtu, gjithashtu, shohim një shembull shumë të mirë të disiplinës së vetë-analizës.)

- Një: Vaizët vazhdojnë të përdorin

të njëjtin stil të shpjegimit që ishte efektiv dhe i vlefshëm në kohët e kaluara. Megjithatë, kushtet e sotme janë shumë të ndryshme. Më parë, ekzistonte një religjiozitet që bazohej në imitim dhe nënshtrimin e verbër.

Për këtë arsye, predikimet e bëra me përshkrime të ngjyrosura kishin ndikim tek njerëzit. Por, sot është epoka e arsyes dhe shkencës. Përshkrimet nuk mjaftojnë më; gjërat duhet të shpjegohen në mënyrë bindëse dhe kënaqshëm shterruese për audiencën.

-Dy: Kur inkurajojnë përmbushjen e urdhrave fetare dhe mosbërjen e gjërave të ndaluara, ata përdorin gjuhë të ekzagjeruar që prish ekuilibrin që feja synon të sjellë. Për shembull, krahasimi i faljes së dy rekateve namaz nate me pelegrinazhin (haxhin) ose barazimi i thashethemeve me amoralitetin ose vendosja e përparësisë mbi çështje që renditen më pas.

-Tre: Ata nuk marrin në konsideratë gjendjen dhe kërkesat e kohës, dhe nuk e marrin parasysh situatën e audiencës, por përpiqen t'i rikthejnë njerëzit në mendësitë dhe mënyrat e vjetra të të menduarit."

Pas këtyre vëzhgimeve, Said Nursi thotë:

"Vaizët tanë duhet të jenë:

1. **قَوِّمُوا مَلَأَعْلًا**: zotërues i dijes që me një sy të kujdesshëm dhe vigjilent rishikon, kërkon prova dhe krahason, në mënyrë që të jetë bindës dhe argumentues.

2. **قَوِّمُوا مَا مِيكَحَلًا**: I mençur, detajist, i përpiktë dhe i kujdesshëm, në mënyrë që të mos prishin ekuilibrin e shariatit (dinjës).

3. **يُنَقِّمُوا غِيْلِبَالًا**: artikulues i aftë për të bindur, në mënyrë që të flasin në përputhje me nevojat e situatës dhe kërkesat e kohës.

**Bediuzzaman Said Nursi**

# MBI KRIZËN MORALE TË MODERNITETIT

Përgjatë historisë, njerëzimi ka ndërtuar kultura dhe qytetërimi të ndryshme sipas një botëkuptimi të caktuar për jetën dhe marrëdhënien e tij me entitetet e tjera. Çdo kohë ka pasur arritjet, sfidat, dhe problemet e saj sipas këtij botëkuptimi, marrëdhënies së njeriut me vlerat dhe kontekstit në të cilat janë zhvilluar. Nëse çdo kohë ka pasur një qytetërim sipas karakteristikave të caktuara, moderniteti si botëkuptim dhe formë e strukturimit shoqëror vijon vazhdimësinë në ditët e sotme. Ai do të vinte fillimisht si një kundërvënie ndaj traditës dhe dimensionit hyjnor si autoriteti kryesor dhe formësuesi i botëkuptimit të njeriut. Kështu njeriu modern do të bënte mendjen e tij si njësi matëse të së vërtetës dhe do të përcmonte traditat e mëdha botërore si Islami Krishterimi dhe Hebraizmi duke i cilësuar ato si të trillime të pakuptimita, librat e tyre të shenjtë si të prapambetur me tregime të popujve të

mëparshëm. Por si ndodhën të gjitha këto?

Pasi njeriu zbriti nga xheneti në tokë vazhdoi jetën e tij sipas udhëzimeve hyjnore. Në tregimet e Kuranit Famëlartë na tregohet për jetesën e popujve të mëparshëm, jetesën dhe marrëdhënien e tyre me mësimet hyjnore dhe qortimin dhe dënimin e tyre kur rebeloheshin ndaj Krijuesit të tyre. Si shfaqje e mëshirës së tij, Allahu ka dërguar profetët për ti udhërrëfyer njerëzit në rrugën e drejtë. Me anë të dritës hyjnore, njerëzimi ka shpëtuar nga injoranca dhe ka ndërtuar një qytetërim mbi diturinë, moralin, mëshirën, dhe drejtësinë. Qytetërimi i ndërtuar mbi themelet e parimeve islame dot të sillte një transformim marramendës në të gjithë aspektet e jetës dhe do të kishte një rol të rëndësishëm në përcaktimin e fateve për të gjithë njerëzimin. Por, sa herë myslimanët duke mbetur në imitim, nuk e kanë gjallëruar lidhjen e tyre me Kuranin duke e reflektuar atë në dituri, filozofi, institucione dhe



arte kanë pësuar një kalbje nga ana morale dhe intelektuale duke ngelur mbrapa në aspektin qytetërimor. Gjithashtu vetëdija dhe ndjenja e krenarisë si përfaqësues i një qytetërimi të madh ka vështirësuar pranimin e humbjes nga myslimanët. Kështu kur ata angazhoheshin me ëndrrat e një qytetërimi madhështor në të shkuarën, bota perëndimore shënoi arritje marramendëse në zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë. Por në anën tjetër nuk mund të flitet për të njëjtin nivel të arritjeve në aspektin human dhe moral të këtij qytetërimi duke çuar kështu në një zhvillim material të shkëputur nga etika që tjetërson njeriun dhe marrëdhënien me natyrën e tij dhe çështjet ekzistenciale.

Epoka e mendimit në Europë do të fillonte me Dekartin. Edhe pse ishte një njeri fetar, ai nuk e parashikoi që me aksiomën e tij "Mendoj, pra ekzistoj", do ti jepte fund sundimit të fesë në aspektin kulturor në mendimin perëndimor. Kjo

tezë e vendos mendimin individual në qendër të marrëdhënies me ekzistencën. Pra, ekzistenca dhe perceptimi janë shpërfaqje e njëra-tjetrës ku të ekzistosh do të thotë të perceptosh. Kjo tezë e Dekartit do të ndikonte që potencialin e njeriut ta bënte njësi matëse të së vërtetës dhe të shfuqizonte kuptimin dhe ndikimin e shpalljes hyjnore dhe librave të shenjtë si udhërrëfyes të mendjes njerëzore. Kështu mendimi perëndimor që do të zhvillohej pas Dekartit duke vendosur mendjen e njeriut në qendër të ekzistencën u besua që do të zbulonte çdo të vërtetë fizike, metafizike dhe morale dhe arsyetimi racional, vëzhgimi dhe eksperimentimi do të bëheshin njësitë matëse dhe përcaktuese të së vërtetës.

Themelet e këtij mendimi do të zhvillonte më tej Kanti i cili e kufizoi burimin e njohjes te përvoja dhe eksperiencia duke u shprehur se vërtetësia e njohjes metafizike është e paprovueshme. Nëse njeriu njeh vetëm atë çka përjeton atëherë nuk

është e mundur të flitet për gajbin dhe njohjen që buron nga revelata hyjnore. Kështu feja u la jashtë fushës së diturive duke marrë formën e një besimi individual. Kjo do të sillte tërheqjen e fesë nga bota e shoqërisë, politikës, kulturës dhe arteve. Me anë të iluminizmit feja ia la këto fusha arsyetimit racional duke u kufizuar thjesht në aspektin personal të njeriut. Kështu duke universalizuar "mendjen" e Dekartit, Kanti kishte përcaktuar një botëkuptim dhe filozofi morale për të gjithë njerëzimin.

"Mendja" e Dekartit e shpalosur te humanizmi i Kantit do të absolutizohej nga Hegeli duke e hyjnizuar atë. Ai do ta kthente në shpirtin e universit duke e shpalosur atë në çdo ekzistencë. Në të kundërtën e Krishterimit ku Zoti zbret në nivelin e njeriut, Hegeli do ta hyjnizonte njeriun duke përfshirë në vetëdijen e tij të gjithë ekzistencën, historinë, artin dhe fenë. Nëse feja vazhdonte të kishte akoma një ndikim në kulturën e mendimit, pas Hegelit ajo e humbi rolin e saj udhërrëfyes duke ia lënë vendin kulturës. Tanimë iluminizmi kishte arritur qëllimin e tij dhe njeriu fliste në emër të Zotit. Të vërtetat që ai zbulonte, mendimet dhe parimet e tij ishin absolute dhe të vërteta. Ndaj Hegeli do të thoshte se çdo gjë e vërtetë është e racionalë dhe çdo gjë e racionalë është e vërtetë. Të frymëzuar nga ky racionalizëm lulëzuan ideologji si kapitalizmi, komunizmi, nacionalizmi, liberalizmi, idealizmi, pragmatizmi, konsumerizmi etj. Kështu filozofia moderne me botëkuptimin që solli krijoi një njeriun në vend të Zotit të fryrë nga egoja e materializuar. Me këtë gjendje, qytetërimi i sotëm do të ndërtonte atë që në gjuhën e misticizmit quhet egoja urdhëruese (nefsi

em-mare). Në këtë kuptim, modernizmin nuk duhet ta shikojmë si "tjetri" përtej nesh por si një sprovë dhe një fazë që duhet kapërcyer duke u përballur me të ashtu sikurse përballemi me dëshirat e neftsit tonë.

Njeriu modern që është vendosur në qendër të ekzistencës duke shkëputur lidhjen me Zotin ka si veti dominuese krenarinë. Në fushën e besimit kjo shfaqet nëpërmjet mohimit dhe rebelimit kundrejt hyjnore në vend të nënshtrimit dhe si rrjedhojë, fetë si krishterimi dhe islami janë përbuzur nga njeriu modern. Në njërën anë kjo është materializuar në ide si agnosticizmi dhe ateizmi e në anën tjetër ai ka vepruar në emër të Zotit duke tentuar reformimin e feve tradicionale dhe shpikjen e shume sekteve dhe besimeve të reja. Krenaria që lind nga botëkuptimi i njeriut modern si sunduesi unik dhe i vetëm i universit, ka çuar në krijimin e një individi të paprekshëm dhe të lirë në të gjithë fushat e jetës. Kështu njeriu duke e parë veten të lirë në zgjedhjet fetare, filozofike, artistike deri te ato më intime ka tentuar të provojë çdo gjë duke konsumuar kështu veten e tij dhe shoqërinë. Në aspektin filozofik mendimet janë reflektuar nëpërmjet ideologjive duke sakrifikuar fetë dhe vlerat tradicionale të shoqërive. Zgjerimi i mëtejshëm i kësaj ndjenje ka sjellë edhe kolonizimin e popujt e varfër nga fuqitë perëndimore duke përhapur më pas konceptet dhe kulturën e saj.

Një veçori tjetër e njeriut modern që përbën një dinamikë ekzistenciale në zhvillimin e modernizmit është edhe lakmia. Ndër të tjera, kapitalizmi është një formë e institucionalizuar e kësaj





lakmie. Shfrytëzimi i burimeve natyrore duke ndotur mjedisin, dhe thellimi më tej i humnerës midis të pasurve dhe të varfërve janë tregues të kësaj ndjenje. Lakmia është motivi më i rëndësishëm që drejton jetën e përditshme të njeriut në botën moderne. Kërkimi pa pushim i një jete më luksoze e çon njeriun në harresën e vetvetes dhe kuptimit të jetës së tij dhe e çon atë drejt një krize dhe konflikti me qenien e tij për të ndikuar negativisht edhe në mirëqenien e tij psikologjike.

Një nga veçoritë dominuese të njeriut modern është edhe epshi, dëshirat dhe kënaqësitë e tij të pafund. Në këtë aspekt liria që synon ti dhurojë lumturinë njeriut e ka thelluar akoma më shumë humnerën ndërmjet tyre. Promovimi i këtyre ndjenjave nëpërmjet arteve vizuale si kinemaja, piktura dhe muzika ka shteruar energjitë krijuese të të rinjve duke i shpërdoruar ato në kotësi. Nëse në të gjitha fetë tradicionale dhe qytetërimet epshi ishte një forcë që duhet mbajtur nën kontroll, në shoqërinë moderne shikohet si burim i krijimit dhe veprimet në lidhje me të janë shkëputur nga etika apo filozofia morale. Sidomos epshi që përbën boshtin kryesor të artit modern e pengon njeriun të zbulojë thellësitë e tij krijuese dhe të arrijë dimensionet e larta shpirtërore në krijimtarinë artistike.

Problemet sociale që kanë shoqëruar njerëzimin në shekujt e fundit siç janë edhe luftërat, kriza morale në të cilën gjendet njeriu modern dhe botëkuptimi mbi të cilin ai është ndërtuar janë tregues që moderniteti nuk përbën më një mundësi për të ripërtëritur shpirtin e tij të trazuar dhe të gjejë vetveten. Çdo njeri mundohet

ti japë zgjidhje këtyre sfidave sipas besimit dhe perceptimit në lidhje me ekzistencën. Në këtë kontekst çdo fe paraqet një botëkuptim të caktuar për jetën, parime të pandryshueshme dhe përbotshme me anë të të cilave e orienton atë edhe në kohë të krizave morale për shoqërinë. Të kuptuarit thellësisht i parimeve të saj dhe ndërtimi i jetës sipas tyre është mundësia për ta tejkaluar këtë sfidë dhe kontribuar në të mirën e shoqërisë. Kështu ndërsa krenaria është prej sëmundjeve shpirtërore të njeriut në ditët sotme, nëpërmjet mësimave hyjnore ai mëson se njeriu merr vlerë nëpërmjet modestisë dhe përlulësisë. Duke njohur fillimisht veten e tij, njeriu kupton dobësinë dhe nevojën për Zotin që çon në përluljen dhe nënshtrimin ndaj tij. Në anën tjetër me anë të modestisë shpirti i tij lartësohet me shumë të Zoti dhe rrezaton dashuri për njerëzit e tjerë. Lakmia si cilësi e dytë e njeriut modern mund të shërohet me anë të virtytit të mjaftueshmërisë dhe mbështetjes te Zoti (tevekkul) pasi njeriu është përgjegjës vetëm për veprat, zgjedhjet dhe përpjekjen e tij e Zoti është ai që mundëson dhe krijon gjithçka që është më e mirë për njeriun dhe shoqërinë. Dhe së fundmi epshi dhe dëshirat e pafund si plagë shpirtërore të njeriut dhe shoqërisë mund të kurohen nëpërmjet maturisë dhe dëlirësisë si dinamikat që me anë të cilave njeriu i jep vlerë, kuptim dhe dinjitet jetës së tij, përfton virtytet e larta dhe ngrihet në majat e smeraldëta të qenies së tij.

**Abdullah Bulku**



# *Dashuria është...*



Më kërkuan të mbaja një fjalë të shkurtër mbi dashurinë në një takim, pikërisht pas ditës së Shën Valentinit. Jam menduar përreth një muaj për këtë temë. Ajo nuk mund të përshkruhet, të kuptohet, kufizohet apo përcaktohet me fjalë. Ne të gjithë kemi lindur me një domosdoshmëri të madhe për të dashur dhe për t'u dashur. Ne nuk e dimë se si funksionon ajo vazhdimisht, mu ashtu si bletët që bëjnë mjaltë pa ditur asgjë rreth përbërjes kimike të ëmbëlsisë çudibërëse. Ne nuk mund ta shpjegojmë dashurinë me anë të fizikës. Ajshtajni thoshte se graviteti nuk është përgjegjës për njerëzit që bien në dashuri. Themi se dashuria është e verbër, por i japim kaq shumë rëndësi veshjes, make up-it, zbukurimeve. Themi se na është copëtuar zemra, por vazhdojmë të duam. Ne nuk do të pinim nga një gotë e thyer, por ashtu siç nuk do të hiqim dorë nga pirja e ujit, nëse të gjitha gotat do të ishin të thyera, zemra jonë e thyer e ruan ende ujin e jetës. Apo mbase do duhej ta thyenim atë vazhdimisht derisa ajo (zemra) të hapet vërtetë.

Dashuria është filli që i mban lidhur të gjitha gjërat – drita dhe jeta e ekzistencës. Ne e duam veten tonë, familjen, vendin ku jetojmë, atdheun tonë, botën, dhe të gjithë universin. Ndiejmë kënaqësi kur njerëzit që duam janë të lumtur dhe ndiejmë dhimbje për fatkeqësitë e tyre. Ndonjëherë është e vështirë ta shohësh diçka si të vyer apo të mrekullueshme, sidomos, kur ajo është e pranishme gjatë gjithë kohës ose kur ke shumë nga ajo gjë. Ne harrojmë se çdo foshnje e shëndetshme është mrekulli. Habitemi me atë që ka shtatë gishta të këmbës, dhe jo me atë që është perfekt. Sa prej nesh ndihen mirënjohës sa herë gëlltisnin diçka, marrin frymë, flenë apo edhe shkojnë në banjë? Nëse dikush humbet gjumin, ose një veshkë, atëherë ai e di sa mirë ishte atëherë kur e kishte atë. Ndoshta, nganjëherë duhet të mendojmë negativisht për të parë sa mirë jemi tani.

Për shembull, ta zëmë se nuk do të kishte dashuri në botë. Vetëm mendo: askush nuk do ta donte bashkëshortin/ten, punën, fëmijët, vendin, punonjësit, nxënësit apo miqtë. Pemët ushqehen vetë me ujë të ndotur, por i ushqejnë fëmijët (frutat) e tyre me sheqer, qumësht, dhe mjaltë. Po sikur ato të mos e bënin këtë? Po sikur ato të bëheshin egoiste papritmas? Po sikur Zoti të mos na donte ne? Të mos i dëgjonte lutjet tona dhe të na dënonte për çdo gabim të vogël që kemi bërë? A do lindte dielli përsëri dhe të na buzëqeshte në mëngjes? A do të binte shiu për t'i dhënë jetë tokës? Mbase jo...dielli i do bimët, bimët e duan diellin. Kafshët i duan bimët dhe ne i duam të gjitha këto. Dashuria bashkon gjithçka dhe gjithkënd. Ajo formon familje, e shndërron një punë apo klasë në argëtim, dhe i bën të durueshme dhimbjet e lindjes. Ajo e bën këtë botë të madhe, të errët e të frikshme, një shtëpi për të gjithë ne.

Kujt ia sheh gabimet më shumë – atyre që i do apo atyre që nuk i do? A nuk i fsheh dashuria të gjitha të metat dhe madje i kthen ato në diçka që mund ta duash më pas?

Nëse do të më duhej të shkruaja një recetë për dashurinë, do të shtoja me tepër dhembshuri se pasion. Shumë marrëdhënie fillojnë me dashuri pasionante, por ato do të

zgjasin më tepër nëse kanë dhembshurinë. Dashuria nuk është të shohësh gjithmonë njëri-tjetrin, ndonjëherë ajo është thjeshtë të shohësh në të njëjtin drejtim.

Natyrë jonë përbëhet nga trupi dhe shpirti. Trupi është për shpirtin siç është një portofol për pasurinë që mban brenda. Është shpirti ai që vlen, jo trupi. Kur shpirti e braktis trupin, trupin nuk e mbajnë në shtëpi, por e varrosin shpejt. Trupat tanë janë si pishtarë. Arsyeja, dituria dhe dashuria jonë janë drita që del prej tij. Ato ndriçojnë udhën tonë. Mos harro se dy enët që ndodhen në trupin tonë, mendja dhe zemra, nuk mbushen kurrë. Sa më tepër të mësosh, aq më shumë mund të mësosh; sa më shumë të duash aq më shumë mund të duash. Shpirtat tanë mund të krahasohen gjithashtu me një oaz. Sjelljet tona, zakonet, pesë shqisat dhe çfarë shohim, dëgjojmë e ndiejmë me to janë si rrëqe që e mbushin atë oaz. Çfarë ka në oaz varet nga çfarë rrjedh nga rrëketë. Me çfarë do ta mbushësh oazin tënd? Me dashuri, urrëjtje, thashetheme, lutje, fjalë të mira, vepra të dobishme? Zgjijdh vetë...

Dashuria është motivuesja e të gjitha kohërave. Era dhe dielli grinden se kush është më i forti. Era tregon me shenjë nga një njeri në rrugë dhe thotë se do t'ia hiqte atij xhakëtën. Megjithatë, sa më fort fryn ajo, aq më fort e shtrëngon burri xhakëtën. Kur dielli shfaq fytyrën e tij, burri e hoqi vetë xhakëtën. Dashuria dhe frika janë dy ndjenja shumë të forta. Ti mund t'i bësh fëmijët të hanë shëndetshëm dhe nxënësit të mësojnë; mund t'i bësh punonjësit të punojnë shumë dhe në përgjithësi mund t'i detyrosh njerëzit t'i bëjnë gjërat duke i frikësuar me fjalë të vrazhda, por ky motivim është i përkohshëm. Kur ti nuk je aty, ata do t'i kthehen zakonit të mëparshëm. Por, nëse ajo zë vend në zemrën e tyre, nëse ata e duan atë gjë, nuk ke pse t'i mbikëqyrësh tërë kohën. Është e pamundur për mua të mos përmend këtu Rumion, shpirtin udhërrëfyes të rrethit të kohës së tij, kur mendoj për dashurinë. Njerëz të të gjitha feve ishin pushtuar prej tij ashtu siç sillleshin rreth dritës fluturat shpirtërore. Atë e titulluan, "Sulltani i të dashuruarve." Dashuria e tij është hyjnore, një dashuri e zjarrtë me përmallim të pashuar. Gjatë ndarjes, ai digjet nga zjarri. Ai nuk shfaq vuajtje, sepse është në kërkim të pasionit. Të përmbajturit nga ankesat është shenjë e besnikërisë ndaj të dashurit. Për të vdekja është si një festival; ajo është një mjet për bashkimin me të dashurin. Rumi u përbashkon dashurinë e Zotit me dashurinë e njerëzimit. Ai doli në përfundimin se të duash njerëzit është të duash Zotin. Një shprehje turke - ne e duam mbarë krijimin, sepse duam Krijuesin – është e ngjashme me këtë.

Ndonëse nuk di ç'të them për dashurinë, shpresoj se të paktën mund ta ndiej dhe ta përhap atë. Unë shpresoj që të gjithë ne t'i kemi jetët të mbushura me dashuri të pafundme. Dashuri, e cila do të na bëjë të duam më shumë, që do të na ndihmojë të jemi njerëz më të mirë dhe të ndiejmë vërtet se jemi të gjallë. Siç thotë Rumi: "Çdo njeri do ta shijojë vdekjen, por vetëm pak prej tyre do të shijojnë jetën."

# Diferenca mes fjalëve grua, bashkëshorte dhe shoqe në Kur'anin Fisnik

Shpesh herë në Kur'anin Fisnik, do gjejmë diferenca në shprehje, për gjëra të ngjashme. Dikush madje, mund ta kalojë pa e vënë re, por tek Allahu i Madhëruar, çdo gjë bëhet me qëllim të caktuar dhe me kuptim të qartë.

Cili vallë është dallimi në mes, grua, bashkëshorte dhe shoqe, në Kuranin Fisnik.

Termi grua ( El Mer'atu):

Nëse ka marrëdhënie trupore në mes një mashkulli dhe një femre, por në mes tyre nuk ka harmoni, bashkërendim

mendimesh e dashuri, quhet grua.

Termi bashkëshorte - ( Ez Zeuxheh): "Nëse ka marrëdhënie trupore mes një burri e një gruaje, por përveç saj ka dhe harmoni, unifikim mendimesh e qëndrimesh si dhe dashuri mes tyre, në këtë rast quhet bashkëshorte.

Ndërsa termin " Shoqe - Sahibeh", Kur'ani Fisnik, e përdor dy raste.

Kur ndërpriten marrëdhënia trupore dhe ideore mes të martuarve.

Ose në rastet, kur kjo marëdhënie nuk ka ekzistuar asnjëherë.

Termi - gruaja - El Mer'atu".

- Në suren Jusuf, do gjejmë që Allahu i Madhëruar nuk thotë: Bashkëshortja e Azijzit ( Kryeministrit), por thotë:

"Gruaja e Azijzit"

Kurani, suretu Jusuf, ajeti 30.

Po ashtu në të njëjtën sure thotë:

"E ai që e bleu nga Misiri ( Egjipti) i tha gruas së tij.."

Kurani, suretu Jusuf, ajeti 21.

Në të 2 rastet, përdoret termi grua dhe jo bashkëshorte. Sepse, megjithëse ishin së bashku, ndanin të njëjtin besim, nuk e gjenin veten tek njëri - tjetri, nuk kishte dashuri dhe harmoni mes tyre.

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: - "Gruaja e Nuhut",

Kur'ani, suretu Et Tahrijm , ajeti 9.

- " Gruaja e Lutit",

Kurani, suretu Et Tahrijm, ajeti 9.

Shkaku, diferenca e sejcilit prej tyre në besim. Gruaja e profetit Nuh a.s, ishte jobesimtare, e megjithëse jetonte me burrin e saj, ishte kundër tij. E njëjta gjë dhe me gruan profetit Lut a.s. Këta të dy ishin profetë, mesazherë të Zotit, ndërkohë që gratë e tyre, ishin në anën e kundërt me ta, pra nuk kishte besim, harmoni, dashuri e respekt të ndërsjellë.

Po ashtu, do gjejmë në Kur-anin Fisnik, termin:

" E gruaja e Faraonit tha:..".

Kurani, suretu El Kasas, ajeti 9.

Kjo për arsye se Faraoni ishte jobesimtar, ndërsa gruaja e tij besimtare. Ata nuk përputheshin në besim e vlera, prandaj ajo është quajtur gruaja dhe jo bashkëshortja.

Po ashtu do gjejmë në Kur'anin Fisnik, kur përshkruan shtëpinë e Ebu Lehebit, megjithëse ata të dy, burrë e grua, ndanin të njëjtat ide, ato të mosbesimit e urrejtjes ndaj besimtarëve, por në mes tyre nuk kishte dashuri, respekt e harmoni.

Në Kur'anin Fisnik thuhet: " E edhe gruaja e tij, ajo që barti drutë.."

Kur'ani, suretu El Mesed, ajeti 4.

- Tani do shohim se ku Kur'ani Fisnik ka përdorur termin: "Bashkëshorte - Zeuxheh".

Allahu i Madhëruar ka thënë për Ademin a.s. dhe bashkëshorten e tij:

"E Ne thamë: O Adem, ti dhe bashkëshortja jote banoni në Xhenet..". Kur'ani, suretu El Bekare, ajeti 35.

Dhe thotë në Kur'anin Fisnik, për profetin Muhamed alejhi selam - mbi të qoftë paqja:

"O ti profet, thuaj bashkëshorteve të tua..".

Kur'ani, suretu Al Ahzab, ajeti 28.

Në këtë rast, mes të dy palëve, ka dashuri, besim, harmoni e respekt reciprok, prandaj është quajtur bashkëshorte.

Ka një veçori në përdorimin e të dy termave, grua dhe bashkëshorte, kur vjen puna tek profeti i Allahut të Madhëruar, Zekeria a.s.

Në rastin e parë do shohim që Zekeria a.s, ka përdorur termi grua 2 herë. Megjithëse mes të dyve, ka pasur përputhje

mendimesh e besimi: "...ndërsa gruaja ime është sterile ". Kur'ani, suretu Merjem , ajeti 5.

Gjë që përsëritet kur, Zekerija i drejtohet Allahut të Madhëruar:

" Zoti im, si do kem unë fëmijë kur gruaja ime ishte që nuk lind..".

Kur'ani, suretu Merjem, ajeti 8.

Arsyeja që Zekeria a.s, në 2 raste ka përdorur termin gruaja e tij dhe jo bashkëshortja e tij, është se, megjithë përputhjen e të dyve në besim dhe në mendime, ka pasur një ftohtësi në mes tyre, shkak, steriliteti i gruas.

Ndërsa në rastin e dytë është përdorur termi bashkëshorte. Kjo, pasi Allahu i Madhëruar i dhuroi fëmijë dhe termi Kur'anor ndryshoi.

"Ne i pranuar lutjet e tij, ia dhuroam atij Jahjain dhe ia përmirësuar bashkëshorten e tij ".

Kur'ani, suretu El Enbija, ajeti 90.

Pra, Allahu i Madhëruar e quajti bashkëshorte, mbas zgjidhjes së problemit të sterilitetit që ajo kishte, gjë që çoi në zbutjen e zemrave të të dyve.

- Ndërsa kur vjen në pah përdorimi i termit të tretë, - "Shoqe -Sahibeh", do shohim që në shumicën e ngjarjeve të Ditës së Gjykimit, Kur'ani ka përdorur termin - Shoqe.

- " Atë ditë njeriu ikën prej vëllait të tij, prej nënës dhe babait të tij, prej Shoqes ( Sahibetih) dhe fëmijëve të tij". Kur'ani, suretu Abese, ajetet 34-36.

Arsyeja e të quajturit " Shoqe", është se marëdhënia trupore dhe mendimore mes të dyve, është ndërprerë për shkak të gjendjes para Ditës Së Gjykimit.

- Rasti tjetër është kur nuk ka pasur asnjë marëdhënie mes njëri - tjetrit, në mënyrë absolute.

Në Kur'an thuhet:

" ..E si do ketë Ai fëmijë, kur nuk pati shoqe ( Sahibeh)..".

Kur'ani, suretu El En'amë, ajeti 101.

Dhe nuk përdor, as termin grua ( Imra'a) e as termin bashkëshorte ( zeuxheh). Kjo, për të mohuar çfarëdo marëdhënie fizike apo ideologjike me palë tjetër, në mënyrë kategorike.

Pa të meta është Allahu i Madhëruar që e zbriti Kur'anin e Tij, një mrekulli për të gjithë ne, ashtu siç thotë në Kur'anin Fisnik :

" Thuaj: "Edhe nëse do të bashkoheshin njerëzit dhe xhindët për të sjellë një Kur'an të tillë, ata nuk do të mund të bënin si ky, sado që do ta ndihmonin njëri - tjetrin".

Kur'ani, Sure El Isra'a ajeti 88.

Pa të meta është Allahu i Madhëruar, Krijuesi ynë, Krijuesi i gjithshkaje që ekziston.

Përgatiti: Bledar Myftari.

Shënim.

Për të sjellë ajetet të përshtatura në gjuhën Shqipe, kam përdorur: "Përkthimi kuptimor i Kur'anit Fisnik" nga Sherif Ahmeti, botimi i Arabisë Saudite.

Por duke përdorur termin e saktë, në sejcilin rast.

**Bledar Myftari**

# GËNJESHTRA ËSHTË VES, JO VIRTYT!

Gënjeshtra është e kundërta e sinqeritetit. Allahu i Madhëruar thotë: "O ju që keni besuar! Frikësojuni Allahut dhe bëjuni me ata që janë të sinqertë (në fjalë dhe në vepra)! (Teube, 119)

Ibn Mesudi r.a. transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë: E vërteta të udhëzon për në rrugën e mirësisë, ndërsa mirësia të shpie në xhenet. Kur njeriu thotë gjithmonë vetëm të vërtetën konsiderohet tek Allahu si njeri i drejtë dhe besnik. Me të vërtetë gënjeshtra të shkatërron dhe të çon në zjarrin e xhehenemit. Kur njeriu e bën shprehë gënjeshtrën, konsiderohet tek Allahu gënjeshhtar." Ky hadith tregon se personi që mundohet të jetë vazhdimisht i saktë dhe i sinqertë në fjalët e tija, saktësia dhe sinqeriteti shndërrohen në tipare të karakterit të tij, ndërsa personi që gënjen me vetëdije duke e shndërruar në shprehë, mashtrimi bëhet tipar i natyrës së tij.

Në Islam gënjeshtra është e ndaluar dhe konsiderohet një nga gjynahet e mëdha. Gënjeshtrë konsiderohet çdo thënie dhe veprim që është i ndryshëm nga fjala dhe vepra reale. Allahu i Lartësuar në Kuran thotë: "Mallkuar qofshin

gënjeshtrarët!" (Dharijat, 10)

Sa gënjeshtra kanë shkaktuar urrejtje dhe armiqësi mes njerëzve?! Sa e sa gënjeshtrarë kanë humbur besueshmërinë e tyre te njerëzit?!

Për fat të keq, në shoqërinë tonë është përhapur shumë kjo dukuri negative. Gënjeshtra dëmton edhe individin, edhe shoqërinë. Ajo nxjerr në pah shpirtligësinë e gënjeshtrartit, qëllimet e ulëta të tija dhe devotshmërinë e pakët që ai ka. Dije se gënjeshtra është njëra prej sëmundjeve më të rënda që mund të përfshijë një shoqëri, është vesi me pasoja negative më të mëdha, sepse nuk mund të paramendohet një shoqëri e mirëfilltë e bazuar në marrëdhënie ndërnjerzore të gënjeshtrta.

Gënjeshtra është burimi i të gjitha të këqijave, origjina e çdo poshtërimit si pasojë e përfundimit të keq dhe rezultatit negativ të saj. Nga gënjeshtra lind shpifja, nga shpifja lind urrejtja, urrejtja të çon drejt armiqësisë së ndërsjellë dhe atëherë nuk ka më as siguri dhe as qetësi.

Islami e ndalon gënjeshtrën, këtë sëmundje të keqe, veti të

shëmtuar dhe të urryer nga çdo njeri me mendje dhe arsye të shëndoshë. Ajo ka pasoja të këqija, shpeshherë edhe fatale. Gënjeshtari është njeri i urryer nga të gjithë dhe në të njëjtën kohë edhe njeri i pabesueshëm. Një fjalë e urtë popullore thotë: "Po gënjeve tërë jetën, s'të besojnë as të vërtetën."

Allahu xh.sh. thotë: "...Largohuni prej fjalëve të rreme." (Haxh, 30). Fjala është pasqyrim i shpirtit dhe i mendimeve tona, d.m.th. kur flasim, mes të tjerash, flet edhe personaliteti ynë, tendencat tona dhe këndvështrimi ynë mbi botën.

Gënjeshtria konsiderohet shenjë e dyftyrëshit (munafikut), Pejgamberi a.s. ka thënë: "Shenjat e munafikut janë tre: kur flet të gënjen, kur të premtim nuk e mban premtimin dhe kur i besohet diçka të tradhëton". (Buhariu, Muslimi)

Për fat të keq, sot ekziston një ditë, të cilën e festojnë shumë njerëz në botë, 1 Prilli apo siç është e njohur te ne "dita e rrenave". Në këtë ditë gënjeshtria është e lejuar pa ndonjë kufi. Viktima e kësaj dite nuk duhet të hidhërohet edhe pse në disa raste pasojat e gënjeshtrove janë katastrofale dhe e dëmtojnë seriozisht atë.

Më e keqja është se kjo 'festë' ka zënë vend edhe në mesin e disa myslimanëve. Ata e festojnë atë edhe pse e dinë se gënjeshtria në Islam është e ndaluar. Ndërsa të tjerët kanë bindjen se kjo ditë është e veçantë dhe dallon nga ditët e tjera. Për myslimanët gënjeshtria është haram. Nuk ka dallim mes 1 Prillit apo 2 Prillit.

Ka disa lloje gënjeshtresh:

1. Gënjeshtria rreth Allahut dhe Pejgamberit a.s.

Gënjeshtria më e madhe është gënjeshtria ndaj Allahut dhe Pejgamberit të Tij dhe beja e rrejshme për Allahun, me qëllim marrjen e pasurisë së myslimanit në mënyrë të padrejtë. Çdo shpjegim apo interpretim që i bëhet fjalës së Allahut pa pasur dijeni rreth saj konsiderohet gënjeshtër në hakun e Allahut. Ebu Bekr Sidik r.a. ka thënë: "Cila tokë do të më mbajë dhe cili qiell do të më mbulojë, nëse do të them për librin e Allahut atë që s'e di." Allahu xh.sh. thotë: "Mos thoni me gjuhët tuaja: 'Kjo është e lejueshme, kjo e ndaluar' dhe kështu të trillon gënjeshtria për Allahun. Me siguri, ata që trillojnë gënjeshtria ndaj Allahut, nuk do të shpëtojnë." (Nahl, 116)

Ibn Kethiri thotë: "Allahu na lajmëron se i Dërguari i Tij, nuk është shpifës dhe as gënjeshtar, sepse ata që shpifin gënjeshtria për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, nuk besojnë në argumentet e Allahut dhe janë të njohur për gënjeshtria. Pejgamberi a.s. ka qenë njeriu më i sinqertë, më i çiltër dhe më i përsosur në dije, në vepra dhe në besim. Ai ka qenë i njohur te njerëzit për sinqeritetin e tij derisa e quajtën (el-emin) "besniku". Prandaj, kur Herakliu, mbreti i romakëve, e pyeti Ebu Sufjanin: A e akuzonit për gënjeshtria Muhamedin para se ai të thoshte që ishte i Dërguari i Allahut? ai iu përgjigj: Jo! Atëherë Herakliu tha: S'mund ta linte gënjeshtërën ndaj njerëzve dhe të gënjente ndaj Allahut." (Tefsir Ibn Kethir)

Në Kuranin famëlartë tregohet se personit që trillon gënjeshtria për Allahun do t'i nxihet fytyra në dynja dhe në ahiret. "Në Ditën e Kiametit do t'i shihni ata që kanë trilluar gënjeshtria për Allahun, me fytyra të nxira. (Zumer, 60)

Gënjeshtër për Pejgamberin a.s. konsiderohet çdo hadith, fjalë, veprim apo aprovim i rremë që i mvishet të dërguarit të Allahut. Pejgamberi a.s. ka thënë: "Mos më atriboni gënjeshtria, sepse ai që më atribon gënjeshtria do të futet në zjarr të xhehenemit". (Buhariu, Muslimi)

2. Gënjeshtria në shitblerje

Pejgamberi a.s. ka thënë: "Tre personave nuk do t'u flasë Allahu xh.sh. në Ditën e Kiametit dhe nuk do t'i shikojë. Ata do të kenë një dënim të dhembshëm. Pejgamberi a.s. e përsëriti këtë tre herë. Ebu Dherri tha: Paskan humbur dhe qenkan shkatërruar, kush janë ata? Profeti tha: "Ata që mbajnë rrobat të gjata nën nyjen e këmbës (nga mendjemadhësia), bartësi i fjalëve dhe ai që e shet mallin e vet duke u betuar rrejshëm." (Muslimi)

Pejgamberi a.s. në një hadith të transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi ka thënë: "Ata dy persona që shesin dhe blejnë me njëri-tjetrin, kanë të drejtë ta blejnë apo ta kthejnë mallin, përderisa nuk janë ndarë nga njëri-tjetri. Nëse thonë të vërtetën dhe tregojnë gjithçka për mallin që shesin, Allahu ju jep begati, por nëse i fshehin (mangësitë e mallit) dhe gënjejnë, shitblerja e tyre nuk ka bereqet."

3. Gënjeshtria ndaj fëmijëve

Duhet bërë kujdes që mos t'i gënjejnë fëmijët, edhe kur jemi duke luajtur me ta. Abdullah ibn Amir thotë: "Një ditë më thirri nëna ime, kur Pejgamberi a.s. ishte në shtëpinë tonë. Ajo më tha: Eja se do të të jap diçka. Atëherë Pejgamberi a.s. tha: Çfarë deshe t'i japësh? Tha: Desha t'i jap hurmë. Pejgamberi a.s. tha: "Po mos t'ia jepje, do të regjistroj si gënjeshtër."

Pejgamberi a.s. ka thënë: "Gruaja që i thotë fëmijës hajde, merre këtë gjë dhe nuk ia jep, ajo është gënjeshtare." (Ahmedi, Ebu Davudi)

Disa nga shkaqet e gënjeshtres

Arsyet dhe shkaqet që i shtojnë njerëzit të gënjejnë janë të shumta. Disa prej tyre janë:

1. Frika e pakët nga Allahu xh.sh. dhe mosdhënia rëndësi faktit se Ai të shikon kudo që të jesh dhe të dëgjon në çdo moment.

2. Përpjekja për të ndryshuar të vërtetën, me dëshirën për të fituar ose për t'i ulur vlerën një malli apo edhe për t'u mburrur.

3. Përshtatja me njerëzit me të cilët qëndron dhe tërheqja e vëmendjes së tyre me tregime dhe informacione të pavërteta.

4. Mungesa e përgjegjësisë dhe përpjekja për të ikur nga e vërteta në kohë krize.

5. Të bërit e gënjeshtres shprehë që në vegjëli, gjë që vjen nga edukimi i ulët. Njeriu që i ka parë dhe i ka dëgjuar që në moshë të vogël prindërit e tij duke gënjuar, ka ndjekur shembullin e tyre derisa e ka bërë gënjeshtërën një zakon të pandarë nga vetja e tij.

Aishja r. anha ka thënë: "Nuk ka patur ndonjë sjellje më të urryer për Pejgamberin a.s. se sa gënjeshtria."

# RAPORTET E KULTURËS SË MYSLIMANIT BASHKËKOHOR ME KULTURAT E TJERA

Muhammed el-Emin esh-Shenkiti, një komentues i rrallë i Kur'anit Fisnik, jep shpjegime tejet domethënëse për qëndrimin e besimtarit musliman karshi kulturave të tjera, që përmbledhet në katër pika kryesore. Të shkëpusim diç nga fjalët e tij në lidhje me çështjen në fjalë.

"...realiteti dëshmon se kultura perëndimore ka gjëra të dobishme dhe të dëmshme. Sa i përket të parës, ajo ka të bëjë me aspektin material, pra me zhvillimin dhe përparimin në të gjitha fushat, madje edhe më shumë se që ishte paramenduar. Ajo, me këtë hap, njeriut – si qenie trupore e gjallë – i ka shërbyer shumë. Ndërsa sa i përket aspektit tjetër, pra atij të dëmshëm, ky ka të bëjë me neglizhimin e edukimit shpirtëror, i cili parimisht nuk mund të bëhet veçse me programin hyjnor, që ia përshkruan njeriut rrugën drejt lumturisë së dy botëve, si dhe e mban atë në lidhje të përhershme me Zotin e tij. Kësisoj, kultura perëndimore ka falimentuar për shkak të mbizotërimit të aspektit material ndaj atij shpirtëror, duke e kërcënuar edhe botën përreth. Zgjidhja e problemeve të saj nuk mund të ndodhë ndryshe veçse me dritën e shpalljes hyjnore, që është ligji i Krijuesit të qiejve dhe tokës, sepse ai, që është mashtruar nga materializmi aq sa e ka harruar edhe Zotin, nuk mund të shpëtojë ndryshe veçse duke iu kthyer Zotit. Ndërsa ndarja e vërtetë përkufizon edhe modalitetet e zgjidhjes, që në fakt është dhe qëndrimi karshi kulturës perëndimore. Kjo përkufizohet vetëm në katër pika:

Braktisja e tërësishme, pra refuzimi i të gjitha aspekteve të saj, të mirave dhe të këqijave;

Përvetësimi i tërësishëm, pa dalluar të mirën nga e keqja; 3) Përvetësimi i së keqes dhe braktisja e së mirës; dhe 4) Përvetësimi i së mirës dhe braktisja e së keqes.

Le të diskutojmë pak për këto katër qëndrime. Tri të parat, pa dyshim, janë shumë të gabuara, për shkak se bien ndesh

me parimet islame. E para, nënkupton braktisjen e çdo gjëje, gjë që është e gabuar ngase ngelja mbrapa në avancimin teknologjik është gabim. Allahu thotë:

"E ju përgatituni sa të keni mundësi force, (mjete luftarake), e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre (që tradhtojnë)..." (el-Enfalë, 60)

E dyta, është po kështu gabim, ngase përvetësimi në tërësi nënkupton edhe përvetësimin e moralit, që do të ishte një katastrofë e madhe për ne. Kultura perëndimore nuk është gjë tjetër veçse një rebelim i llojit të vet kundër Krijuesit dhe ligjit të Tij. Allahu thotë:

Thuaj: "Më thoni, atë që All-llahu ju dha si ushqim (të lejuar), e ju nga ai diçka bëtë të ndaluar e diçka të lejuar?" Thuaj: "A ju lejoi All-llahu ju, ose ju shpifni për All-llahun?" (Junus, 59)

"A mos kanë ata ortakë (zota ose idhuj) që u përcaktuan atyre fé, të cilën nuk e urdhëroi All-llahu? Po sikur të mos ishte fjala vendimtare (e All-llahut që shpërblimi dhe ndëshkimi të jenë në Ahiret), do të kryhej dënimi mbi ta, e megjithatë, mohuesit do të kenë dënim të dhembshëm." (esh-Shura, 21)

Opsioni i tretë refuzohet për shkak të qasjes së papranuar që paraqet. Ai nënkupton përvetësimin e aspekteve negative, gjë kjo që refuzohet apriori. Kësisoj, mund të përfundojmë se opsioni i mbetur, i katërti, është i qëlluari, për shkak të korrektesisë dhe drejtpeshimit. Kështu veprimi i Dërguari i Allahut [alejhissalatu ves selam]. Ai përfitoi nga hapja e hendekut në Betejën e Ahzabit, që si strategji ushtarake ishte e persianëve, sikurse që përfitoi edhe nga të tjerët gjëra të tjera të rëndësishme. Gjatë Hixhretit ai kishte angazhuar një jomusliman si udhërrëfyes. Si konkluzion



mund të themi se qëndrimi ynë karshi kulturës perëndimore është që të marrim aspekte që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe avancimin teknologjik dhe t'i braktisim të tjerat, pasi që morali, etika dhe kultura jonë na mjaftojnë. Ky është parimi, por praktika, mjerisht, është ndryshe. Muslimanët kanë përvetësuar të kundërtën, duke rrezikuar kështu humbjen e dynjasë dhe ahiretit.

"Ka nga njerëzit që adhuron All-llahun me mëdyshje (luhatshëm), nëse e godet ndonjë e mirë ai qetësohet me të, po nëse e godet ndonjë e pakëndshme, ai kthehet në fytyrën e vet të vërtetë (të mëparshme), ai e ka humbur këtë dhe jetën tjetër e ky është ai dështimi i qartë." (el-Haxh, 11)

Sa bukur është kur tek individ bashkohen feja dhe dynjaja dhe sa shëmtim është kur bashkohen pabesimi dhe falimentimi (humbja).

Kështu, bazuar në këtë që thamë, mund të përfundojmë se kultura jonë në raport me të tjerët ngrihet mbi këto baza:

1) Dallim, por edhe përfitim. (إدافت سال او زيمتلا) Muslimani duhet të dallohet nga të tjerët në besim, adhurim dhe sjellje (edukatë), gjë për të cilën aludohet në Kur'an:

"Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni All-llahun. E sikur ithtarët e librit të besonin drejt, do të ishte shumë më e mirë për ta.

Disa prej tyre janë besimtarë, po shumica e tyre janë larg rugës së Zotit." (Ali Imran, 110)

"Me ithtarët e librit mos polemizoni ndryshe (kur i thirrni në fenë tuaj) vetëm ashtu si është më së miri, përveç atyre që janë mizorë dhe thojuni: "Ne i besuam asaj që na u zbrit neve dhe që u zbriti juve dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një, dhe se ne i jemi dorëzuar Atij." (el-Ankebut, 46)

"(Përkujtoni) Kur ne morëm zotimin e bijve të Israilit; mos adhuroni tjetërkë përveç All-llahut, të silleni mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmeve, ndaj jetimëve, ndaj të varfërve dhe njerëzve thojuni fjalë të mira. Faleni namazin dhe jepni zeqatin, e pastaj ju e thyet zotimin dhe përveç një pakice prej jush, ia kthyet shpinën zotimit." (el-Bekare, 83)

Përputhje, jo pëshqjellim. Muslimani është i urdhëruar t'i harmonizojë parimet e kulturës së re të fituar me parimet e kulturës islame. Kjo është ajo që sot po e quajmë 'islamizim i dijes.' Procedura e përputhjes kalon nëpër disa faza ose realizohet nëpërmjet disa mjeteve, si: vlerësimi i asaj kulture sipas peshojës islame, në mënyrë që të bëhet filtrimi i saj nga çdo gjë që mund të jetë e papranuar në Islam. Kështu përputhjen mund ta bëjmë duke iu shmangur çdo gjëje që do të ishte e refuzuar nga këndvështrimi ynë islam. Ndoshta

ajeti që do të përmendim në vijim aludon në këtë domethënie. Allahu thotë:

"O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek Allllahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat), e All-llahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë." (el-Huxhurat, 13)

Pranim, jo shkrirje. Muslimani duhet të pasojë rrugën e pejgamberëve dhe të përvetësojë metodën e tyre. Allahu duke na folur për metodat e tyre thotë:

"Ne ia pranuar lutjen atij, ia dhuruam atij Jahjain dhe ia përmirësuar bashkëshorten atij. Ata përpiqeshin për punë të mira. Na luteshin duke shpresuar dhe duke u frikësuar, ishin respektues ndaj Nesh." (el-Enbija, 90) Në këtë ajet aludohet kjo që thamë. Muslimani intelektual, që ka dije për fenë dhe dynjanë e tij, nuk e pranon assesi shkrirjen dhe asimilimin në kulturat tjera. Islami është feja e vetme që i ruan identitetet etnike të njerëzve. Diversitetin e vlerëson si pasuri dhe si demonstrim të fuqisë absolute të Allahut.

"Nga argumentet e Tij është krijimi i qiejve e i tokës, ndryshimi i gjuhëve tuaja dhe i ngjyrave tuaja. Edhe në këtë ka argumente për njerëz." (errRrum, 22)

Këtë e dëshmon praktikisht historia e perandrive tona islame, në historinë tonë klasike dhe moderne.

4) Refuzim, por jo bojkotim. (إعطاقملا ال صفرلا) Islami ynë urdhëron për pranimin e së mirës, çfarëdo qoftë ajo, sidomos kur kemi parasysh aprovimin e disa traditave të periudhës para islame, si: dhënia ushqim, nderimi i mysafirrit, guximi, tavafi në Haxh, ecja ndërmjet Safasë dhe Merves etj. Allahu thotë:

Lutja e tyre pranë shtëpisë (Qabesë) nuk ishte tjetër vetëm se britmë dhe duartrokitje, prandaj vuajeni dënimin për shkak se mohoni." (el-Enfalë, 35)

Kjo duhet të aplikohet edhe në jetën bashkëkohore tek muslimanët. Jo çdo gjë perëndimore është e refuzuar. Ne pranojmë të mirat, kuptohet gjithnjë sipas kriterit se ato nuk duhet të jenë në kundërshtim me fenë. Ne mund ta aplikojmë edhe kriterin e bojkotit, sidomos nëse vërejmë se ata janë duke e nënçmuar fenë tonë ose tallen me të, siç ka ndodhur këto vitet e fundit. Por, ajo që të çudit është se me gjithë këto marrëzi të Perëndimit dhe me gjithë këto shkelje të të drejtave tona që na bëhen prej tyre, prapëseprapë muslimanët vazhdojnë biznesin me ta, sikur të mos ketë ndodhur kurrëgjë!!!

Si përfundim mund të themi se kjo është platforma sipas së cilës duhet të veprojmë me të tjerët.

Allahu e di më së miri!

**Prof.Dr.Hfz Hajredin Hoxha**

# Disa çështje rreth pushimeve



Ja dhe shkolla mbaroi për këtë vit. Bashkë me përfundimin e një viti shkollor, prindërit i shqetëson më shumë mendimi se si fëmijët do t'i kalojnë këto pushime.

Çdo prind dëshiron që fëmija i tij të lexojë, të punojë ekstra në lëndët ku ka çaluar gjatë vitit shkollor dhe t'i shfrytëzojë pushimet në mënyrën e duhur, por, në të vërtetë, ata përballen me dembelizmin, përtacinë, varësinë ndaj televizorit dhe pajisjeve teknologjike. Jo çdo fëmijë mund të shprehë dëshirën të ndjekë programin e dëshiruar të prindit. Prandaj, para fillimit të sezonit veror, është shumë e rëndësishme të flisni dhe të diskutoni bashkë me fëmijët tuaj (për/rreth) mënyrën se si do ta shfrytëzojnë verën dhe planin që duhet të bëni në mënyrë që këto 3 muaj të gjatë të mos shndërrohen në tre muaj, të cilët nxisin mërzinë dhe depresionin.

Pushimet verore mundësojnë zhvillimin, zbulimin e aftësive, maturimin e fëmijëve. Një kohë kaq e bollshme duhet kaluar me një plan, sa efektiv, aq dhe produktiv. Më poshtë do të japim disa këshilla për prindërit:

Pikë së pari, nxiteni fëmijën të ndajë me ju ndjenjat pozitive dhe negative të lidhura me dëftesën. Përpuni të jeni të sinqertë me të dhe mos përdorni fjalë apo ton ofendues nëse ai ka dalë me rezultate të padëshiruara. Ndërtoni empatinë e duhur dhe kuptoni ndjenjat e tij. Mos kaloni shumë kohë duke vlerësuar dëftesën, sepse kjo do të krijojë një ndjenjë presioni te fëmija.

Diskutoni me fëmijën se si mendon t'i shfrytëzojë pushimet verore dhe cilat janë fushat ku mendon të fokusohet.

Bëjani të ditur se ju jeni të gatshëm t'i jepni ndihmën dhe mbështetjen e kërkuar.

Përpuni të njihni fëmijën tuaj, të vlerësoni objektivist anën e tij pozitive e negative, dhe të arrini që t'ia transmetoni këtë edhe atij. Për këtë arsye përgatitni mundësinë ku ai të shpalosë aftësitë dhe talentin.

Mos bëni plan në vend të fëmijës tuaj, por planifikoni bashkë me të. Shumë familje përjetojnë debate në lidhje me përcaktimin e një plani veror. Zakonisht prindërit mbajnë dy qëndrime, atë autoritar, ku bëhet çfarë mendon e thotë prindi, dhe atë shumë demokratik, ku vendimi lihet në dorë të fëmijës. Në këtë rast debatet përfundojnë me fitoren e njëres palë dhe humbjen e tjetrës. Shtëpia nuk duhet të kthehet në një fushëbetejë ku shpaloset autoriteti dhe fuqia, por një vend ku ndahet dashuria dhe përgjegjësitë.

Përpuni të gjeni një rrugë të mesme ku të harmonizohen dëshirat tuaja dhe të fëmijës. Dhe

mos harroni: Përpilimi i një plani është shumë herë më efektiv se indiferentizmi dhe mos-përpilimi i tij.

Ja disa këshilla të arta:

Dëftesa të mos vendoset në qendër të vëmendjes: Pas vlerësimit objektiv të dëftesave të dobëta fëmijëve u duhet dhuruar dashuri dhe siguri. Qëndroni larg krahasimit të fëmijës suaj me fëmijë të tjerë. Fëmijët që kanë marrë një dëftesë shembullore duhen falënderuar për përpjekjet e bëra.

Të mos bëhemi robër të internetit: Pajisjet teknologjike si: telefoni, tableta, kompjuteri, etj., nuk duhen përdorur në mënyrë të pakontrolluar. Mungesa e kontrollit sjell varësi dhe humbje përqendrimi te fëmijët. Nëse prindërit nuk bëjnë një plan veror, atëherë fëmijët do ta kalojnë të gjithë verën para televizorit apo internetit. Në këtë mënyrë do të pengohet zhvillimi mendor dhe fizik i tyre dhe do t'i hapet rrugë shumë problemeve.

Të vlerësohen kurset e gjuhëve të huaja: Regjistrimi në një kurs gjuhe do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e fëmijëve. Krahas kësaj, këto kurse ndikojnë në përdorimin efektiv të kohës dhe planifikimin më frytdhënës të verës.

Të përpilohet një listë e librave që mund të lexohen: Lista duhet të përpilohet duke u bazuar në nivelin dhe dëshirat e fëmijës. Nxitja e fëmijëve në zbatimin e përmbajtjes së kësaj liste përbën një hap të rëndësishëm. Nëse është e mundur, leximi i librave të bëhet familjarisht, duke bërë analizën dhe diskutimin rreth vendeve më të pëlqyera. Mund të caktohen orare të veçanta të leximit bashkë si familje.

Forcimi i marrëdhënieve familjare: Kalimi i pushimeve verore pranë të afërmeve apo kushërinjve mund të ndikojë pozitivisht në forcimin e marrëdhënieve familjare. Duke u bërë vizita familjarëve, fëmijët arrijnë të kuptojnë shpirtin e familjes dhe të zbulojnë rëndësinë e bashkimit.

Të organizohen shëtitje: Vizita e qyteteve të ndryshme apo edhe shteteve, nëse mundësitë ekonomike e lejojnë, gjallëron dhe pasuron mendjen e fëmijëve me vlera kulturore e historike.

Të frekuentohen kurse sportive, muzike apo pikturë: Kurset verore mundësojnë zbulimin e aftësive dhe talenteve të fëmijëve dhe ndihmojnë zhvillimin e ndjenjave estetike. Për këtë mund të shihen kurset e muzikës, pikturës, etj.

**Redaksia**



# MORALI I LARTË I RESULULLAHUT DHE SJELLJET E TIJ QË U BËNË SHKAK PËR UDHËZIMIN E NJERËZVE

Abdullah bin Selami (radijallahu anhu) ka thënë kështu: "Kur Allahu dëshiroi udhëzimin e Zejd bin Sunes, Zejdi tha: "Nga të gjitha shenjat e profetësisë, sado qofshin ato, përveç dy syresh, unë i kam dalluar të gjitha në atë fytyrën e bukur të tij. Për ato dy cilësi nuk kisha dëgjuar asgjë të thuhej. Ato dy cilësi ishin të qenët i butë, i dashur dhe që butësia t'ia kalonte e ta mbulonte çdo çast nervozizmi dhe që gabimet dhe sjelljet e pahijshme që i bëheshin t'ia shtonin edhe më tepër butësinë e ndjenjën faljes." Ja se si vijon të tregojë Zejdi më tej:

"Një ditë, Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), bashkë me Aliun (radijallahu anhu), dolën nga porta e dhomës së njëres prej bashkëshorteve të tij. Në atë moment, aty pranë kaloi një beduin i hipur mbi deve, i cili u tha:

- "O i Dërguari i Allahut! Në aksh vend kisha disa njerëz të mitë, ishin bërë myslimanë. U pata thënë, 'nëse bëheni myslimanë, atëherë si malli, si pasuria do t'ju shtohen, do t'ju shumëfishohen'. Mirëpo, nga mungesa e shirave dhe thatësira ata kanë mbetur shumë ngushtë. O Resulullah, kam shumë frikë, se ashtu siç e pranuan Islamin nga tamahu për më shumë pasuri, mund të heqin dorë sérish e të kthehen edhe njëherë në fenë e tyre të mëparshme. Po deshe t'u dërgosh ndonjë ndihmë, mund të ma japësh mua e ua çoj unë."

Në atë kohë, i Dërguari i Allahut hodhi njëherë vështrimin nga Aliu (radijallahu anhu) që e kishte përkrah. Ai njeri i tha:

- "Nuk na ka mbetur më asgjë, o i Dërguari i Allahut!"

Atëherë unë (Zejd bin Sune) iu afrova dhe i thashë:

- "O Muhamed! A mundet, që, për njëfarë kohe, të na e shesësh një pjesë të hurmave të filanëve me një çmim të ulët?"

- "Mos më përcakto një vend të caktuar, si pemishtja e hurmave të filanit, apo të ndonjë tjetri.", - më tha i Dërguari i Allahut.

- "Në rregull.", - i thashë unë, dhe kësisoj u morëm vesh. E hapa trastën dhe për një pjesë të hurmave, për një kohë të caktuar, i pagova plot tetëdhjetëmijë monedha floriri. Ndërsa ai ia dha të gjitha monedhat atij beduini, të cilit i tha:

- "Shko dhe ndihmoji ata njerëz të përmbushin nevojat e tyre!"

Zejd bin Suneja, në vijim, thotë: Kishin mbetur edhe dy-tri ditë nga koha që ishim marrë vesh për përdorimin e hurmave. Erdhën Profeti ynë bashkë me Ebu Bekrin, Omerin, Osmanin dhe disa sahabë të tjerë. Pasi falën namazin e xhenazes, u afruan të uleshin ndanë një muri. Shkova menjëherë pranë tyre dhe e kapa nga këmisha që kishte veshur, e pashë si me një fytyrë paksa të ashpër dhe i thashë:

- "O Muhamed, duhet të më paguash! Uallahi, ju bijtë e Abdulmuttalibit nuk dini gjë tjetër, veçse të shtyni pagesën e borxheve. Unë kam marrëdhënie të shumta me ju dhe ju njoh mjaft mirë."

Në atë kohë pashë njëherë edhe nga Omeri, sytë i lëviznin me rrëmbim, e dukej që ishte nevrikosur tej mase. Më hodhi një shikim dhe më tha:

- "More armik i Allahut! Si guxon t'i flasësh kështu të Dërguarit të Allahut? Si guxon ta prekësh kështu të Dërguarin e Allahut? Të betohem për Allahun, se po të mos ngurroja se do të fillosh të urresh Islamin, do ta nxirrja shpatën nga brezi e do të ta kisha ndarë atë kokë nga ato shpatulla!"

I Dërguari i Allahut po më shihte gjithë qetësi dhe me një seriozitet të pashoq, i palëkundur. Pastaj pa njëherë nga Omeri dhe i tha:

- "Omer, neve na nevojitet diçka tjetër, jo kjo sjellje e jotja! Ti duhet të më këshilloje mua që t'ia paguaj borxhin këtij njeriu dhe atë ta këshilloje që ta kërkonte me të mirë kthimin e borxhit! Hajde, Omer, shko me të dhe paguaja sa i bën haka dhe t'i japësh edhe njëzet hurma më shumë, meqë e trembe!"

Omeri më mori me vete. Përveç asaj që më takonte, më dha edhe njëzet masa me hurma më shumë.

- "O Omer, po pse kaq shumë?", - e pyeta.

- "Kështu më porositi i Dërguari i Allahut.", - u përgjigja ai. - "Meqë të tremba."

- "Po mua, nuk më njohe, o Omer?", - e pyeta unë.

- "Jo, nuk të njoha."

- "Unë jam Zejd bin Suneja."

- "Rabini?!", - pyeti ai i habitur.

- "Po, rabini Zejd."

- "Po pse u solle ashtu me të Dërguarin e Allahut, pse i fole ashtu?", - më pyeti ai.

- "O Omer, përveç dy shenjave të profetësisë, të gjitha të tjerat unë i kisha dalluar në fytyrën e ndritur të të Dërguarit të Allahut që kur e takova atë për herë të parë. Por për këto dy shenja nuk kam dëgjuar kurrë asgjë: kur butësia ia mposht nevrikosjen dhe ajo e shtimit edhe më shumë të butësisë kur dikush tregohet i pasjellshëm me të, apo kur shfaq mungesë respekti. Ja pra, duke vepruar kështu, i mësova edhe ato. Ja, o Omer, të kam ty dëshmitar, se unë jam i kënaqur me Allahun si Zot, me Islamin si fe dhe me Muhamedin si profet dhe i Dërguar i Allahut. Të kam ty dëshmitar, që gjysmën e pasurisë, e ti e di se unë jam shumë i pasur, e jap si lëmoshë për umetin e Muhamedit!", - iu përgjigja unë.

- "Thuaj më mirë 'një pjese të umetit të Muhamedit', se nuk mjaftojnë për të gjithë umetin e tij."

Kësisoj, edhe unë e rregullova atë shprehje të testamentit tim, duke thënë 'një pjese të umetit të Profetit Muhamed'.

Transmetuesi i hadithit thotë: "Omeri dhe Zejdi (radijallahu anhu) u kthyen tek i Dërguari i Allahut, Zejdi tha fjalën e dëshmisë, duke shpallur sakaq besimin e tij tek i Dërguari i Allahut. Kështu e shprehu ai besëlidhjen e vet. Dhe, tok me Profetin tonë, ai mori pjesë në shumë beteja që u bënë në emër të Islamit. Jetën e humbi gjatë betejës së Tebukut. Allahu e trajtoftë me mëshirë Zejdin."

**Shkëputur nga libri "Jeta e Sahabëve 1"**

**M. Jusuf Kandeheui  
Botim i KMSH**

*Të  
njohim  
veten*

Ne jetojmë mbi një top të rrumbullakët, vendosur diku në hapësirë. Njohim shumë gjëra, por ajo që lypset na ka mbetur e errët dhe e pazgjidhur.

Përparimi material ka arritur mjaft lart, aq sa s'ta merr mendja. Shkenca ka mundur të vërë në pah shumë pikëpamje të ndryshme të jetës lëndore. Janë përpiluar volume librash, ku flitet përgjithësisht mbi njeriun dhe mbi organizmat t'unjtra. Dituritë, në njëfarë kuptimi, mund të përmbliidhen kështu: Shkenca e organizmës; e mendjes dhe e aktiviteteve dhe e prodhimit të këtyre. Mirëpo të gjitha këto studime të thella s'kanë mundur të hyjnë në esencën e njeriut.

Shkenca moderne, megjithëse ka nxjerrë në dritë mjaft gjëra për dobinë tonë, prapë është shumë mbrapa për sa i përket zbulimit të vërtetë të natyrës së njeriut.

Janë shkruar me mijëra faqe enciklopedie dhe prodhuar me miliona vepra letrare për të njohur gjëra të panumërta, por cili ka shkruar ndonjë enciklopedi mbi njohjen e vetvetes! Dijetarë të mëdhenj, me largpamjet e tyre, kanë mundur të bëjnë studime të imëta e të mbledhin informata të shumta gati mbi çdo send në botën e jashtme, por s'kanë ditur të kuptojnë veten. Kanë bërë vepra madhështore, kanë ngritur pallate gjigante, i kanë bërë transformime të çuditshme lëndës, por s'kanë qenë të aftë të zgjidhin problemin e thjeshtë të "Unit". Mendja ka mundur të bëjë lloj-lloj shpikjesh, që ndihmojnë në lehtësimin e barrës së njeriut, por s'është përpjekur të depërtojë në misterin e vetes.

Ç'është arsyeja që njeriu të njohë veten para së gjithash? Sepse vetja është i vetmi realitet me të cilën kemi të bëjmë më tepër se me çdo gjë tjetër. Krejt faktet qark nesh si dhe mendimet që rezultojnë prej tyre, janë të vlefshme e të dobishme vetëm atëherë, kur neve të meritojmë për to. Njeriu njej dhe çmon vetëm kur të njohë vetveten. Mistikët e mëdhenj me stërhollimin e këtij problemi kanë mundur të realizojnë këtë gjendje aq të dëshiruar prej të gjithëve. Ata dëftuan se bota materiale do të mos ekzistonte e veçantë prej kuptimit.

Ç'është atëherë vetja? S'ka sekret në Librin e Natyrës që me kohë e durim s'mund t'i arrihet për pa studiuar veten. As një kyç (dry) s'është bërë pa hapësin (çelësin) e përshtatur dhe ne dëndur mund të njohim Mjeshtrin e Natyrës nga ajo e njeriut.

Studimi i saktë i vetvetes një ditë do të na çelësin kryesor për të hapur të gjitha portat filozofike të të tëra shkencave dhe problemeve të pazgjidhura të jetës. Vetja është kreu dhe fundi – është e para që njohim si fëmijë dhe do të jetë e fundit kur të realizojmë urtësinë e brendshme në pajtim me botën e jashtme.

Siguria më e madhe në dituri vjen vetëm kur të kemi zhvilluar në përplotësim cilësitë e fshehta në sferën e vetvetes. Ne s'mund të çmojmë botën dhe sendet që gjendet në të veç kur ndjenjat e shqisat të kenë arritur përsosurinë. Prandaj jemi të shtrënguar të kthehemi, herët a vonë, në studimin e rëndësishëm të vetvetes, së cilës çdo i mençur lypset t'i kushtojë energjinë e duhur të tij.

Një i urtë shkoi te një i dijetar i moçëm dhe i bëri këto pyetje, për çka mori këto përgjigje të sakta me përjashtim të njërës:

- Kush është i pari dhe i fundit në këtë botë?
- Zoti, sepse është i përgjithmonshëm.
- Cila është më e bukur se të gjitha?
- Gjithësia, sepse kjo është vepra-pasqyrë e Zotit.
- Çka është më e madhja e të tërave?
- Hapësira, sepse përmbledh çdo send të krijuar.
- Cila është më e qëndrueshme në botë?
- Shpresa, se kjo mbetet me njeriun edhe pasi ai të ketë humbur çdo gjë tjetër.
- Ç'është më e mira e të krejtave?
- Virtyti, se pa të s'ka gjë të mirë.
- Ç'është më e shpejtë se të gjitha?
- Mendja, se në më pak se një minutë mund të shkojë në fund të gjithësisë.
- Cila është më e fortë se çdo gjë tjetër?
- Nevoja, e cila e bën njeriun të përballojë tërë rreziqet e jetës.
- Ç'ka është më e lehtë se të gjitha?
- Të dhënit këshilla.

Kur erdhi te pyetja e fundit i dituri dha një përgjigje, që sigurisht vetë nuk e kuptonte dhe se gjithë njerëzit e ditur materialistë s'mund t'i japin veçse një kuptim të sipërfaqshëm. Pyetja ishte: Çka ishte më e vështira e të gjithave?

Përgjigja ishte: Të njohim veten.

**Botuar në revistën "Njeriu", Nr. 3-4, shtator-tetor 1942.**



(70/80 Hixhri)

# JETA E PRIJËSIT EBU HANIFE



## 1. LINDJA E EBU HANIFES

EBU HANIFE, i pari i Medh'hebit tonë Hane'fî, ka lindur në vitin 70-të ose 80-të Hixhri (650 ose 660). Gjyshi i Ebu Hanifes, Zuta, erdhi nga Kabeli te z. Ali (r.a.) i cili ishte Khalif në atë kohë dhe banonte në Kufe. Zuta nga fjalët e kujdesi i z. Aliut r.a. përqafoi fenë Islame. Në këtë kohë z. Aliu vuri dorën e tij mbi kokën e Zutës dhe u lut për të dhe brezin e tij. Më vonë tregon Ebu Hanife se: "Na ka vlej-të duaja (Lutja) e z. Aliut r.a."

Ebu Hanife, kur ishte i vogël, mësonte shumë Kur'an dhe mbas një kohe e mësoi atë përmendësh. Shpesh herë shkante të këshillohej të Hoxha i tij që i kishte mësuar Kur'anin. Ai ndihmonte edhe babain e vet në dyqan ku shiste rroba e sende të ndryshme.

## 2. FILLIMI I DIJES

Ebu Hanifeja, djalë i ri, një ditë po kalonte nëpër pazar afër një dyqani. Aty pa duke ndenjur prijësin Shaabi dhe e përshëndeti. Në këtë kohë prijësi e ndaloi dhe e pyeti se ku po shkonte. Ebu Hanifja iu përgjigj se ishte nisur për në dyqanin e babait të vet për ta ndihmuar. Prijësit iu duk djalë i mirë dhe i shkathët dhe e porositi që të mësonte. Ebu Hanifeja tregon më vonë: "Fjala e prijësit Shaabi më ra në zemër e më bëri shumë përshtypje, e kështu fillova të studioj». Në këtë kohë filloi të merrej me lëndën AKAIID (BESIM) dhe përparoi shumë, aq sa u bë i njohur në shumë vende ku përhapit dijet e tij. Ai shkoi në Basra 27 herë e doli fitimtar kundër ateistëve, disa herë në Firak, në Batini etj. Ndërkohë shkruan edhe librin e tij të shkurtër "Fikhu më i madh", i cili njihet edhe sot dhe është komentuar disa herë.

## 3. DIJA NË FIKH

Pasi studioi mirë lëndën Akaid (Besimi), në moshën 27 vjeç, la këtë temë dhe filloi studimin e Fikhut, lëndë që merret me sjelljet mekanike ndërmjet njeriut dhe Zotit xh.sh., me veten, prindërit,

të afërmit, lidhjet mekanike me të tjerët, me vdekjen dhe trashëgiminë e njeriut. Ebu Hanifeja vazhdoi studimet tek mësuesi i tij z. Hamadi, djali i Ebu Sulejmanit, të cilit i shërbente duke i blerë ushqimet e sende të tjera të nevojshme për shtëpi dhe pastaj priste tekdera deri sa Hoxha ta thërriste për ta mësuar. Me vullnetin e tij, me interesimin e tij dhe me mendjen e tij të hollë arriti të bëhet nxënësi më i mirë. Ai për 18 vjet

vazhdoi studimet tek Hoxha i tij, i cili në këtë kohë u largua nga qyteti për disa ditë.

Gjatë këtyre ditëve Ebu Hanifja e zëvendësoi Hoxhën duke mësuar të tjerët. Mbas pak kohe vdiq

Mësuesi dhe Ebu Hanifja e zëvendësoi atë plotësisht.

## 4. GRADA E LARTË

Kur Ebu Hanifja ishte bërë dijetar i njohur, u takua me prijësin Ebu Xhafer el Mensuri. Djali i Musait, Isai, i tha Ebu Xhaferit: "Ebu Hanifja është dijetar i botës". Ai e pyeti: "Nga kush e ka marrë këtë dije Ebu Hanifja?" Isai iu përgjigj: "Nga Omeri dhe shokët e tij, nga Abdullahi, djali i Mes'udit dhe shokët e tij, që në kohë të Ibni Abasit, nuk ka qenë kush më dijetar se ai. «Ebu Xhaferi tha: "E paska dijen e saktë". Siç dihet, Ebu Hanifja e ka njohur sahaben Enes, djalin e Malikut e disa sahabe të tjerë dhe ka mësuar nga 4000 dijetarë.

## 5. RINIA E EBU HANIFES

Ebu Hanifja e kalonte kohën duke studiuar, lexonte Kur'anin dhe u falte aq shumë, sa që e këndonte komplet Kur'anin në falje. Një natë hyri në Qabe e fali dy reqatë dhe me ata dy reqatë e mbaroi së kënduari krejt Kur'anin.

Misari, një dijetar i njohur na tregon: "Fala Jacinë një natë në xhaminë ku printe Ebu Hanifja. Kur përfundoi falja, u ndanë njerëzit e unë qëndrova. Mbas pak u kthye Ebu Hanifja e u fal deri para Sabahut. Shkoi në shtëpi për pak kohë dhe fali Sabahun Imamë».

Ebu Mukatili na tregon: "Nuk kam parë njeri që u falte dhe e adhuronte Zotin xh sh. sa Ebu Hanifja". Prijësi i Khurasanit, Abdullahi, djali i Mubareqit, tregon për Hanifen: «Atij burri iu afruan të gjitha të mirat dhe ai ua solli shpinën. E rrahën me këmba, sepse nuk pranoi të bëhej gjykatës i parë, refuzoi të mirën dhe duroi të keqen. Beto hem se nuk ka qenë si disa dijetarë të tjerë që kërkonin të mirat e botës. Ebu Hanifes i vinin këto të mira e ai nuk i pranonte ato». Jahja Katani,

Një nga prijësit e Hadithit shkruan: «Kam ndenjur me Ebu Hanifen dhe kam mësuar shumë prej

tij, kur shikojsha fytyrën e Ebu Hanifes, thojsha me vete se ky njeri me të vërtetë e adhuron shumë

Zotin xh.sh.»

## 6. EBU HANIFJA MËSUES

Ebu Hanifja ka qenë një mësues shumë i zoti dhe ka pasur shumë studentë. Studentët më të mirë ai i bënte anëtarë të një këshilli që ai kishte formuar. Ky këshill përbëhej prej 40 anëtarësh nga fusha të ndryshme të dijes. Kur e pyesnin Ebu Hanifen për ndonjë çështje, ai e bisedonte me studentët dhe anëtarët e këshillit, ku secili thoshte atë që dinte për problemin. Në fund Ebu Hanifja

thoshte fjalën e vet, e cila shpesh herë ishte çelësi i përgjigjes së duhur. Shumë nxënës të Ebu Hanifes kanë studjuar Hadithet, si p.sh. Jahja Katani, Vekiu, Abdullahi, djali i Mubareqit, Jahjai, djali i Ebu Zahides, etj. Disa studentë tjerë janë marrë me Fikh si p.sh. Ebu Jusufi, Muhamedi, Zuferi etj. Disa të tjerë janë marrë me studimin e gjuhës.

Ebu Hanifja ndihmonte shumë të vobektit. Shembull për këtë është Ebu Jusufi, një djalë i ri e i vobektë, që mësonte tek Ebu Hanifja, por njëkohësisht punonte edhe te mjeshtri i tij. Mjeshtri e shikonte se Ebu Jusufi nuk ishte shumë i interesuar për punën dhe e paditi tek prindërit për këtë gjë dhe ata e ndaluan për disa ditë që të mos shkonte për të mësuar tek Ebu Hanifja. Një ditë Ebu Jusufi mbas faljes qëndroi për t'u takuar me mësuesin e vet i cili e pyeti se për ç'arsye nuk vinte të dëgjonte mësimet. Ebu Jusufi i tregoi arsyen. Në këtë kohë Ebu Hanifja i dha 100 derhem dhe i tha: "Merri këto, shpenzoji për familjen dhe për vete, lene punën dhe vazhdo mësimet, unë përsëri do të jap." Në këtë mënyrë Ebu Jusufi vazhdoi mësimet deri sa i përfundoi dhe hyri në punë.

## 7. SJELLJET E TIJ

Një nga tiparet kryesore të sjelljes së Ebu Hanifes ishte nderimi dhe përujja ndaj Zotit

xh.sh. Për këtë, siç e theksuam edhe më sipër, u falte shumë natën e duke u falë, këndonte krejtë Kur'anin. Ninonte shumë dhe ndihmonte hoxhallarët, studentët dhe ndante për çdo të Xhuma diçka për shpirt të prindërve të vet. Zyferi thotë që kam shoqëruar Ebu Hanifen më tepër se 20 vjet e nuk kam parë njeri që ndihmonte të tjerët më shumë se ai. Ai linte veten keq për të ndihmuar të tjerët.

Kohën më të madhe të ditës u merrte më studime, duke mësuar nxënësit e tij dhe duke i sqaruar për pyetjet që i bënin. Vizitonte të sëmuret dhe shkonte në xhenaze të atyre që vdisnin Natën u falte shumë dhe lexonte. Misari na tregon se, kur blente diçka Ebu Hanifja për familjen e vet, patjetër do të blinte edhe për hoxhallarët e tjerë. Për të provuar nivelin e dijeve të Ebu Hanifes, saktësinë dhe paanshmërinë e tij po sjellim një shembull të cilin e citon Dhehebiu në librin e tij për jetën e Ebu Hanifes. «Abdu-rrezaku tregon se ishim një ditë në xhami të Minase (Në hoxh). Aty

një njeri pyeti për një çështje dhe tha se Hasan Basriu më ka thënë kështu. Ebu Hanifja iu përgjigj se në këtë çështje ka gabuar Hasan Basriu, ndërsa e ka thanë të saktë Abdullahi, djali i Mesudit».

## 8. MENDIMET E DIJETARËVE TE KOHES PER EBU HANIFEN

Misari, djali i Kidamit ka thënë: «Kush vë ndërmjet vetes dhe Zotit xh.sh. Ebu Hanifeñ, shpresoj se i plotësohet kërkesa e nuk do të frikësohet. Shafiu r.a. ka thënë: «Asnjë nuk ka arritë ta studiojë Fikhun pa iu mbështetë Ebu Hanifes».

Ebu Jusufi thotë se dijetarët tregonin që Zoti xh.sh. e ka zbukuruar Ebu Hanifen me Fikh, shkencë dhe Kur'an.

Ahmedi, djali i Hanbelit, ka thënë: «Ebu Hanifja ka qenë një njeri shumë i ditur,

është ruajtur nga e ndaluara (harami) dhe ka besuar në jetën e ardhshme në atë shkallë sa nuk e ka arritë kush. Është rrahë edhe me kamzhik, që të bëhet gjykatës i Khalifatit nga Ebu Xhafer el Mensuri, por nuk pranoi. Zoti xh.sh. pastë mëshirë dhe rahmet».

## 9. BAZA E DIJES SË TIJ

Vetë Ebu Hanifja tregon se si ka punuar: «Unë e marr dijen nga Kur'ani. Në se nuk e gjej aty kërkesën apo temën që më duhet, atëherë kërkoj nga Hadithet e Profetit a.s., në qoftë se edhe aty

nuk gjej gjë, atëherë kërkoj nga fjalët e Sahabeve zgjedhi fjalët e njerit prej sahabeve dhe nuk dal jashtë fjalës së tyre. Kur të arrij tek Shabi e disa dijetarë të kësaj kohe, mendoj mirë dhe vendos ashtu si më duket më e saktë.

Ebu Hanifja ka përpunuar ndonjë hadith të pa qartë që mund të ishte edhe 30% i saktë. Në këto raste ka thënë: «Është më e mirë se falja e kujdo tjetër. Në këtë mënyrë është përpjekur të bashkojë faktet e të punojë me to. Për të vertetuar këtë po sjellim një shembull. Ka ndonjë hadith të Buhariut që thotë: Nuk pranohet falja pa kënduar «ELHAMDU LILLAHIN», ndërsa Ebu Hanifja duke punuar me ajete dhe me hadithe thotë: «Me këndue Kur'anë në falje është farz, ndërsa me këndue «Elhamin» dhe pak Kuranë mbas Elhamit është vaxhib (e domosdoshme)».

Shafiu e disa të tjerë, duke punuar me hadithe kanë thënë se është e detyrueshme të këndohet Elhami në falje, ndërsa Ebu Hanifja ka punuar me ajete dhe hadithe.

Profeti a.s. thotë: Nuk pranohet falja pa këndu «ELHAMIN». por ka thënë edhe: «Ai që falet mbas

Imamit, mos të këndoje Kur'anë, këndimi i Imamit i mjafton». Pikërisht kështu ka thënë edhe Ebu Hanifja, Malikja e Hanelia nuk

pranohet të këndohet Kur'ani në falje, kur jemi të prirë mbas Imamit». Në të kundërt, Shafija thotë: Duhet të këndohet ELHAMI në çdo gjëndje».

Abdullahi, djali i Mubareqit, ka thënë: "Mos thoni fjala e Ebu Hanifes, por thoni Hadithi i Ebu Hanifes, sepse ai ka njoftë shumë mirë hadithin e jo siç veprojnë disa dijetarë të rinj që e venë në dyshim këtë».

Ebu Hanifja ka mbledhë 40000 hadithe nga dijetarë të ndryshëm dhe ka shkruar 17 libra të hadithit. Këtë na e vërtetojnë shumë dijetarë të saktë e me emër. Zyferi tregonte se shumë dijetarë të mëdhej të hadithit, si Mutarifi, Zekiria vinin dhe e pyesnin Ebu Hanifen për probleme të ndryshme. Ebu Hanifja ka qenë i interesuar për ta kuptuar hadithin, për të gjetë çka i lidh ose çfarë kanë të përbashkët hadithet me njeri-tjetrin, ose hadithet me ajetet e fjalët e sahabeve. Ebu Hanifja është quajtur edhe Imam në hadith.

Disa, prej zilisë ose edhe prej padijes, kanë folë keq për Ebu Hanifen, por ata kur u njohën më thellë me veprën e punën tij, nuk folën më. I tillë ka qenë p.sh. prijësi Ouzai etj.

## 10. VDEKJA E EBU HANIFES

Ebu Xhaferi, që kur jetoi Ebu Hanifja, ishte prijësi i Bagdatit, donte ta detyronte atë që të bëhej kryegjykatës, por Ebu Hanifja nuk pranoi. Për këtë edhe e burgosi e për disa ditë edhe e rrahën me nga dhjetë kamzhikë. Pasi doli nga burgu, vdiq në Bagdat në vitin 150 (Hixhri)

Pastë rahmet, gjetët tek Zoti xh.sh. të mirat që ai ka punuar gjithë jetën.

AMIN!

**Vehbi Sulejman Gavoçi**

# SHËRIMI I BRENGAVE DHE PROBLEMEVE NËN HIJEN E KUR'ANIT DHE SUNETIT

## Çfarë synojmë me shërim?

Kur'ani dhe Suneti posedojnë ilaç për shërimin e pikëllimit dhe brengave, sidomos nëse ato janë shkaktuar nga faktorë të jashtëm. Ky është imazh i mëshirës së Allahut të Madhëruar ndaj robërve të Tij, ngase Kur'anin e bëri shërim dhe mëshirë për besimtarët, ndërsa këtyre të fundit nuk iu mbetet gjë tjetër pos të kthehen kah Kur'ani dhe Suneti i Pejgamberit a.s., që të shpëtojnë e të ngadhënjëjnë me lumturi dhe prehje shpirtërore në të dy botët.

## Besimi

Besimi ka ndikim të madh në ruajtjen dhe shërimin nga brengat dhe problemet e ndryshme. Fjalën 'besim' e dëgjojmë shpesh, por të paktë janë ata që kuptojmë esencën, reflektimet dhe

rezultatet e tij.

Besimi lë gjurmë të thella në ndjenjat dhe sjelljet e njeriut. Këtu do të paraqesim disa aspekte të tij në ruajtjen dhe mbrojtjen nga pikëllimi.

## Kadaja dhe Kaderi (Caktimet paraprake të Allahut të Madhëruar)

Besimi ynë në këto caktime të Allahut të Madhëruar pengon nga pikëllimi i madh. Pejgamberi a.s. ka thënë: "...dhe dije se sikur tërë njerëzit të bëheshin bashkë për të të bërë ndonjë të mirë, nuk do të mundnin po të mos e ketë shkruar Allahu për ty. Po kështu, (edhe) sikur të bëheshin bashkë për të dëmtuar diç, nuk do ia arrinin qëllimit po të mos e ketë shkruar Allahu."

Kur njeriu bindet se gjërat janë të caktuara prej Allahut të Madhëruar, ai nuk brengoset shumë. Si



të pikëllohet kur e di se njerëzit nuk mund t'i bëjnë dëm dhe as dobi pa caktimin e Allahut?! Atëherë përse ky ankth? Përse ky pikëllim i madh?

#### **Besimi në Ditën e Llogarisë**

Ai që beson në Ditën e Llogarisë, e di se në këtë botë nuk ka të mira të përhershme. Kur besimtari qëllon të humbasë diç nga kjo botë, ai nuk pikëllohet pasi e di se kjo botë, në raport me ahiretin, nuk vlen asgjë. Ai përkujton fjalën e Pejgamberit a.s.: "Sikur dynjaja të vlente tek Allahu vetëm sa një krah mushkonje, askujt që e mohon Atë nuk do t'i jepte as një gllënjikë ujë për të pirë." (Tirmidhiu)

#### **Besimi në emrat dhe cilësitë e Allahut të Madhëruar**

Disa mendojnë se besimi në emrat dhe cilësitë e Allahut të Madhëruar është çështje teorike e besimit pa pasur ndonjë ndikim a gjurmë në jetën dhe sjelljet e besimtarit. Si shkak i këtij botëkuptimi të gabuar, ata nuk përfitojnë nga besimi i tyre atë që duhet.

Besimi në këto çështje nuk është vetëm teorik, formal, verbal. Ai ka një ndikim të madh te njeriu. Ai që beson se Allahu është Sundues, beson se Ai ka të drejtë në dhënie dhe privim. Ai që beson se Allahu është i Urtë, e kupton apo jo urtësinë e ndonjë gjëje, beson se ajo ka urtësi.

#### **Botëkuptimi i besimtarit për sprovat dhe pikëllimet**

Botëkuptimi i fatkeqësive te myslimani është i veçantë dhe meriton të shkruhet me ngjyrë ari.

Besimtari beson se sprovat mund të vijnë edhe si shenjë e dashurisë së Allahut për njeriun. A nuk ka thënë Pejgamberi a.s.: “Nëse Allahu e do një grup njerëzish, i sprovon.” (Imam Ahmedi)

Po kështu beson se sprovimi është në përputhje me nivelin e besimit, duke përkujtuar hadithin: “Njerëzit që më së shumti sprovohen janë pejgamberët, pastaj të mirët pastaj shkallë-shkallë.” (Taberaniu)

Besimtari po kështu beson se me t’u sprovuar me fatkeqësi, ai do të shpërblehet. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Nuk ndodh të goditet besimtari nga ndonjë lodhje, mundim, brengë, pikëllim, shqetësim, madje edhe ferra që i hyn në këmbë, e që Allahu të mos ia falë me të mëkatet.”

Nëse njeriu e beson këtë, atëherë ai ndihet i qetë me besimin e tij në Allahun e Madhëruar, kurse mbështetja në Të dhe nënshtrimi ndaj Atij vetëm sa i rrënjosen edhe më thellë në zemër.

Po si do të kishte qenë puna nëse tërë kësaj ai t’ia shtonte edhe durimin? Padyshim se do të shpërblehej shumë. Allahu thotë: “... ndërsa të duruarve u jepet shpërblimi i tyre pa masë!” (Zumer, 10)

Myslimani, çfarëdo që të jetë gjendja e tij, është fitimtar. Muslimi transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Çudi është puna e besimtarit, tërë çështja e tij është në favor për të dhe për askënd tjetër pos tij. Nëse privilegohet me ndonjë të mirë, falënderon, e kjo është mirë për të. Nëse sprovohet me ndonjë fatkeqësi, duron, e kjo është mirë për të.”

Pra, botëkuptimi ynë për sprovën është i veçantë.

### **Devotshmëria dhe veprat e mira**

Devotshmëria dhe vepra e mirë e ruajnë besimtarin nga pikëllimi, brengosja dhe ankthi. Allahu i Madhëruar thotë: “Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t’i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t’u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre.” (Nahl, 97)

Atëherë ç’është jeta e mirë?

A nuk është lumturia dhe qetësia?

Po, për Zotin, tërë ata që kërkojnë lumturinë dhe tërë ata që imagjinojnë jetën e mirë nuk do ta shijojnë as atë dhe as këtë pa punuar vepra të mira. Ka thënë Ibrahim b. Ed’hemi: “Për Zotin, ne jemi duke jetuar një jetë të begatshme që po të dinin mbretërit dhe bijtë e tyre për të, do të na

luftonin me shpatë (që ta kenë-përvetësojnë atë).”

Pra, kjo është dhuntia e besimit dhe qetësisë. Është lumturia e vërtetë, të cilën shumë njerëz nuk e kanë gjetur.

### **Lutja, madhërimi dhe namazi**

Duaja është mbrojtëse, por edhe shëruese, siç tregohet për shembull në këtë hadith: “O Zoti im, kërkoj të më mbrosh nga brenga dhe pikëllimi, dobësia dhe përtacia, koprracia dhe frika, nga mundja prej borxhit (borxhi i madh) dhe nga mposhtja e njerëzve.”

Ai që beson në këtë dhe hadithe të tjera të ngjashme, kur goditet me ndonjë sprovë, e lexon atë dhe Allahu i Madhëruar ia largon pikëllimin dhe brengën. Allahu i Madhëruar i drejtohet Muhamedit a.s. që nga fjalët e jobesimtarëve që mërëzitur shumë: “Ne dimë mirë se ti ngushtohesh shpirtërisht për atë që thonë ata. 98. Po ti madhëroje me falënderime Zotin tënd e bëhu prej atyre që luten (përuken duke u falur). 99. Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të vijë e vërteta (vdekja).” (Hixhr, 97-99)

Pra, madhërimi i Allahut është çelës i rrugëdaljeve dhe zgjidhjeve të problemeve.

Shikimi tek ata që janë sprovuar edhe më shumë dhe mendimi i gjendjeve edhe më të këqija

Kjo është një praktikë e psikologëve, të cilën para tyre e përdori Pejgamberi a.s. Habbab b. el Eretti kur kishte parë sahabet të vuanin në Mekë, kishte shkuar te Pejgamberi a.s. dhe i kishte thënë: “A nuk po e lut Allahun e Madhëruar të na ndihmojë? A nuk po lutesh për ne? Pejgamberi a.s. iu përgjigj: “Para jush (në kohët e mëhershme) njeriu merrej, i hapej një gropë në tokë ku vendosej dhe me një sharrë të hekurt i ndahej mishi nga ashti, por kjo nuk e largonte prej fesë së tij. Pasha Allahun! Ai do ta plotësojë këtë fe derisa kalorësi (ai që udhëton me ndonjë kafshë) të ecë nga San’aja e deri në Hadrameut dhe të mos ketë frikë askënd përveç Allahut dhe ujkut për delet e tij. Ju po nguteni pak.” (Buhariu)

Kjo është mënyrë psikike e të shëruarit. Nëse takohesh me ndonjë njeri të sprovuar, përkujtoja njerëzit që janë sprovuar edhe më shumë se ai. Nëse dikujt, për shembull, i ka vdekur babai, thuaji se ka familje të tëra që kanë pësuar në aksidente të tilla. Apo thuaji se edhe pse iu ka vdekur babai, ju materialisht qëndroni mirë, ndërsa familja e filanit ka mbetur pas vdekjes së tij shumë keq.

Kur njeriu të goditet me ndonjë fatkeqësi, duhet të marrë mësim nga ata që gjendjen e kanë edhe më keq se ai dhe të thotë: Falënderuar qoftë Allahu! Unë mirë jam.

I varfri shikon atë që është edhe më i varfër.

### **Realizmi në këndvështrimin e jetës dhe largimi nga përsosmëria përrallore – idealizmi**

Disa njerëz brengosen ngase mendojnë gabimisht. Të mendosh: "Unë nuk mund të jem i lumtur përderisa njerëzit pranë meje të mos jenë të kënaqur me mua", "Nuk mund të ndihem i qetë përderisa nëpunësit e mi, të gjithë, të mos janë të kënaqur me mua" - është gabim dhe, realisht, diçka e pamundur. Patjetër që do të ketë njerëz që nuk do të ndahen të kënaqur me ty. Sikur njeriu të jetonte me parimin se është e pamundur kënaqja e tërë njerëzve, ai do të jetonte i qetë dhe pa brenge. Abdurrahman es Sa'dijj në librin "El vesail el mufide lil hajati's seideh – Mjetet e dobishme për një jetë të lumtur", në koment të hadithit: "Besimtari nuk e urren besimtaren; nëse nuk i pëlqen ndonjë tipar i saj, i pëlqen tjetri", thotë: Ky hadith udhëzon për (mirë)sjellje me gruan, të afërmin, shokun dhe tërë ata me të cilët ke lidhje. Duhet ta bindësh veten se ata patjetër kanë ndonjë të metë që ti e urren, por kur ta gjesh këtë krahasojë me gjërat që ti i ke obligim. Thënë më qartë, krahasojë me gjërat që e mbajnë gjallë lidhjen mes jush duke mos shikuar të metat ngase konsiderata ndaj mirësive mban gjallë shoqërinë dhe lidhjet si dhe arrihet qetësia.

### **Opinioni i mirë**

Aspektet pozitive gjithnjë duhet t'iu paraprijnë atyre negative. Njeriu që vetëm ndan mendime të këqija për njerëz, është ai që vuan më shumë. Për shembull: Një njeri kalon pranë një tjetri dhe nuk i jep salam. Ky tjetri mbetet i hutuar dhe i pikëlluar: Përse nuk më përshëndeti? Sigurisht që më urren. Kështu ai fillon të supozojë dhe të jetojë në një gjendje të tillë me ditë të tëra. Sikur t'i ikte këtij mendimi ndoshta do të ndihej i qetë dhe do të mendonte: "Po ai nuk më pa, ndryshe do të më jepte salam", e gjëra të tjera që zhdukin supozimin dhe pjellën e tij: pikëllimin. Për këtë Allahu i Madhëruar thotë: "O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat..." (Huxhurat, 12)

Ky largim nga supozimet është për të mirën tonë, ndryshe, ne jemi ata që qetësohemi nëse mendojmë mirë, duke mos harruar këtu

se mendimi i mirë nënkupton mashtrimin apo tradhtinë e personit që supozon për të. Omeri r.a. ka thënë: "Unë nuk jam tradhtar (mashtrues, njeri që nuk ka një qëndrim), por as tradhtari nuk më mashtron dot."

Myslimani nuk është intrigant dhe as nuk tradhton njerëzit, por as nuk tradtohet ngase është vigjilent.

### **Trajtimi i arrogancës së të tjerëve**

Ndodh që njerëzit të shqetësojnë me fjalët e tyre të liga, por ti duhet ta dish se kjo i dëmton ata e jo ty, përveç nëse e preokupon veten me fjalët e tyre, që më pas do të ndëshkohesh me ngushtim shpirtëror. Po braktise këtë, do jetosh i lumtur ngase Pejgamberi a.s. ka thënë: "A e dini kush është i falimentuar (mufflis)?" Sahabet thanë: "I falimentuar te ne është ai i cili nuk ka as para e as mall". Tha: "I falimentuar i umetit tim është ai që vjen në Ditën e Gjykimit me namaz, me agjërim, me zekat, por njëkohësisht ai ka sharë atë, ka përgojuar këtë, ka ngrënë pasurinë e atij, ka derdhur gjakun e këtij, ka rrahur tjetrin, atëherë i jepen këtij e atij (atyre që i ka dëmtuar) prej të mirave të tij dhe nëse harxhohen mirësitë e tij para se t'u paguhen borxhet, atëherë do të merren prej mëkateve të tyre dhe do t'i ngarkohen këtij, pastaj edhe ky do të hidhet në zjarr." (Muslimi)

Pra, ai që më merr nëpër gojë, më shan dhe flet keq për mua, ai në të vërtetë më dhuron veprat e tij të mira. Allahu e shpërbleftë! Më duhet ta falënderoj për këtë!

Nëse dikush të thotë diçka të keqe, largohu prej tij dhe lëre ashtu ngase ai do të pikëllohet. A nuk thotë Allahu: "...Thuaju: "Vdisni me atë mllef tuajin!..." (Ali Imran, 119)

### **Shpresa**

Dera e shpresës është e hapur. Kështu largohet pikëllimi dhe mërzia nga njeriu. Le të përkujtojmë fjalën e Allahut të Madhëruar: "E, pa dyshim se pas vështirësisë është lehtësimi. / Vërtet, pas vështirësisë vjen lehtësimi." (Inshirah, 5-6)

Kjo do të thotë se pas çdo vështirësie vjen lehtësimi, siç na mëson Allahu: "...mirëpo pas vështirësisë Allahu sjell çlirim (begati)." (Talak, 7)

Sa herë që gjërat të vështirësohen, dije se zgjidhja është afër.

**Përshtati: Dr. Sedat Islami**



Medreseja e  
**Tiranës**

# OLIMPIADAT KOMBËTARE

Filluan përgatitjet

**2,3 & 4 SHTATOR**

Për lëndët

- SHKENCAT E NATYRËS
- SHKENCAT SHOQËRORE